



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional  
"Menaxhim Biznesi", me profile: "Menaxhimi i SME-ve",  
"Menaxhimi i Burimeve Njerëzore", "Menaxhim dhe  
Vlerësim Projektsh", "Administrim Territori"**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Europian i  
Tiranës"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Raimonda Duka
2. Prof As. Dr. Eglantina Hysa


Dhjetor / 2022



## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Master Profesional "Menaxhim Biznesi, me profile"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profile
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 74, dt. 21.01.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit periodik:	VBA Nr. 32, datë 13.07.2018 (i rishikuar me VBA Nr. 32/1, datë 07.12.2018)
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plot
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2018-2020 9 PAE / 3 PAK 2019-2020 9 PAE / 2 PAK 2020-2021 7 PAE / 5 PAK 2021-2022 9 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	66 studentë viti akademik 2018-2019 62 studentë viti akademik 2019-2020 34 studentë viti akademik 2020-2021 22 studentë viti akademik 2021-2022
19	Komente / të tjera:	-






## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Europian i Tiranës" ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2006, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave, VKM Nr. 636, datë 20.9.2006 "Për licensimin e Shkollës së Lartë Private "Universiteti Europian i Tiranës". Universiteti Europian i Tiranës ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.46, date 05.07.2019, me kohëzgjatje 3 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022.

Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në "Menaxhim Biznesi", është licensuar për herë të parë në vitin 2009, si Master i Nivelit të Parë (MNP) me Vendim Nr. 74, dt. 21.01.2009 të Këshillit të Ministrave si dhe është akredituar për herë të parë në vitin 2011 me Urdhër të MASH Nr. 68, dt. 14.02.2011. Më pas ky program është përshtatur nga institucioni si program i Ciklit të Dytë Master Profesional, në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë në fuqi. Akreditimi periodik i programit u bë me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 32, datë 13.07.2018 (i rishikuar me VBA Nr. 32/1, datë 07.12.2018) me kohëzgjatje 4 vite, për 3 (tre) profilet: Menaxhimi i SME-ve; Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës; dhe Institucione dhe Administrim Publik. Përpara fillimit të vitit akademik 2018-2019, në zbatim të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 dhe ndryshimeve ligjore përkatëse, programi u përshtat përsëri në Master Profesional "Menaxhim Biznesi" me 5 profile: Menaxhimi i SME-ve; Menaxhimi i Burimeve Njerëzore; Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh; Administrim Publik; dhe Administrim Territori. Ndërkohë, në bazë të Shkresës Nr. 78/71 Prot., dt. 23.12.2022, drejtuar Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, UET ka kërkuar akreditimin e programit vetëm për 4 (katër) profilet aktive të tij, konkretisht: "Menaxhimi i SME-ve", "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh", "Administrim Territori".

Programi ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, i licensuar si Fakulteti Ekonomik me VKM Nr. 255, datë 27.02.2008, dhe i riorganizuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 527, datë 04.09.2018. Programi i studimit realizohet me 60 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi" me një nga profilet përkatëse.

Qëllimi i këtij program studimi është të përgatisë profesionistë dhe manaxhere në fushat e Menaxhim Biznesit, të profilizuar sipas fushave përkatëse dhe të pajisur me njohuri bashkëkohore teorike dhe shprehje të duhura praktike, për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut, të biznesit.





## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 32, datë 13.07.2018, i ndryshuar janë:

1. Institucioni të marr masa për rekrutimin e stafit të ri akademik, për mbulimin në mënyrë të plotë të lëndëve dhe moduleve të këtij programi.
2. Institucioni të parashikojë rekrutimin e stafit me grada dhe tituj akademikë me qëllim uljen e ngarkesës dhe numrit të lëndëve/moduleve për pedagog.
3. Të realizohet një shpërndarje efektive e lëndëve dhe në përputhje me fushën e ekspertizës së stafit akademik.
4. Institucioni të përmirësojë raportin udhëheqës/student me qëllim uljen e numrit të madh të studentëve të mbikëqyrur nga një pedagog njëkohësisht.
5. Institucioni të shoh mundësinë e ofrimit të një lënde të këtij programi studimi në gjuhë të huaj, me synim ndërkombëtarizimin e programit të studimit.

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Programi i studimit mbulohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut. GVJ mbështetur në dokumentacionin që përmban DVV dhe nga vizita në institucion konstatoi që për periudhën 2018-2022 Departamenti ka patur në përbërjen e tij 8 dhe më shumë antarë, pjesa më e madhe e të cilëve (mbi 80.0%) me grada dhe tituj akademik<sup>1</sup> Për periudhën 2018-2022 janë aktivizuar në këtë program studimi personel akademik efektiv dhe me kontratë si më poshtë:

Viti akademik 2018-2020 9 PAE / 3 PAK

Viti akademik 2019-2020 9 PAE / 2 PAK


Viti akademik 2020-2021 7 PAE / 5 PAK

Viti akademik 2021-2022 9 PAE / 1 PAK

Në vitin akademik 2020-2021 është angazhuar numri më i madh i PAK në këtë program studimi. Megjithatë 71.4% e ngarkesës mësimore në këtë vit akademik është realizuar nga PAE, duke plotësuar në këtë mënyrë VKM 418, datë 10.05.2017, neni 2, pika b/ii, që kërkon që personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70.0% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi<sup>2</sup>. GVJ është e mendimit se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

<sup>1</sup> Ref. 02. Tabelat përmbledhëse për aneks, fq. 3-4

<sup>2</sup> VKM nr.418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre"





2. Ligji Nr. 80/2015 ka përcaktuar që ngarkesa minimale mësimore për personelin akademik në institucionet jopublike përcaktohet nga vetë institucioni<sup>3</sup>. Megjithatë, IAL ka bërë një shpërndarje të ngarkesës mësimore duke respektuar udhëzimin 29, datë 10.09.2018, pika II/1<sup>4</sup>. Nga evidencat e DVV, GVJ konstatoi që i gjithë personeli akademik efektiv ka realizuar orë mësimore në auditor në kufijtë 213 deri në 283 orë. Në vitin akademik 2020-2021 4 (katër) nga 7 (shtatë) antarët e personelit akademik efektiv kanë patur në ngarkesën e tyre mësimore vjetore 4 (katër) lëndë semestrale<sup>5</sup>. Pavarësisht sa mësipër në tre vitet akademike ka patur angazhim të personelit akademik që nuk ka patur kualifikimin e ciklit pasardhës. **GVJ është e mendimit që rekomandimi është përmbushur kryesisht.**

3. GVJ mbështetur në dokumentacionin që përmban DVV (syllabuset dhe CV-të e personelit akademik) dhe nga vizita në institucion, konstatoi që shpërndarja e lëndëve është bërë në përputhje me fushën e ekspertizës të stafit akademik. Lëndët që mbulon personeli akademik në ciklin e dytë në shumë raste janë nivele të thelluara të lëndëve që i njëjti pedagog mbulon në ciklin e parë. **GVJ është e mendimit që rekomandimi është përmbushur plotësisht.**

4. GVJ duke iu referuar dokumentacionit në dosjen e vetëvlerësimit, konstatoi që IAL ka bërë ndryshime në rregulloren mësimore mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSh", në nenin 75, pika 6 i cili parashikon që studimet e ciklit të dytë "Master Profesional" përmbillen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome. Rregullorja mësimore parashikon që mbrojtja të bëhet përmes një *projekti profesional me karakter aplikativ/praktik*. Ndërsa studentët e tjerë duhet të japin një provim të përgjithshëm përfundimtar<sup>6</sup>

Ndryshimet në rregullore kanë sjellë një rënie të ndjeshme të numrit të studentëve që përmbyllin programin e studimit me punim diplome. Kështu në vitin akademik 2018-2019 e përmbyllën PS me punim diplome 37.3% e studentëve. Ndërsa në vitin akademik 2020-2021 kanë mbrojtur diplomën me punim projekti vetëm 6% e studentëve<sup>7</sup>. **GVJ është e mendimit që rekomandimi është përmbushur plotësisht.**

5. Institucioni nuk ka detyrim ligjor që të ofroj lëndë të programit të studimit në gjuhë të huaj, pasi licenca është lëshuar nga MAS për program studimi në gjuhën shqipe. GVJ mbështetur në dokumentacionin që përmban DVV dhe nga vizita në institucion konstatoi që pavarësisht kësaj IAL ka ofruar dy lëndë të programit në gjuhën angleze; përkatësisht Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (Human Resource Management) dhe Aftësitë Manaxheriale (Managerial Skills). Këto dy lëndë janë në planin mësimor të Masterit të Shkencave dhe Masterit Profesional dhe mund të ofrohen në shqip dhe anglisht. GVJ nuk arriti të verifikojë nëse përmbushja e këtij rekomandimi ka ndikuar në *ndërkombëtarizimin e programit të studimit*. **Pavarësisht kësaj GVJ shprehet se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**


<sup>3</sup> Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSh", neni 59, pika 8.

<sup>4</sup> Udhëzimi nr. 29, datë 10.09.2018 Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë

<sup>5</sup> Ref. 25. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit (Aneks Tabela 4)

<sup>6</sup> Ref. 5 Rregullore e UET, neni 39.1, fq.10

<sup>7</sup> RVB, fq. 4, tabela (% është llogaritur nga antarët e GVJ-së)





## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, përzgjedhi dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Dr. Raimonda Duka dhe Prof. As. Dr. Eglantina Hysa.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional "Menaxhim Biznesi", me profile: "Menaxhimi i SME-ve", "Menaxhimi i Burimeve Njerezore", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh", "Administrim Territori" ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, pranë Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës” filloi me trajnimin pranë ASCAL, marrjen e dokumentacionit të ofruar nga institucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë.

Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako. Në bashkëpunim me kordinatorin teknik të ASCAL u caktuan datat e vizitës në institucion dhe u përgatit axhenda e takimeve që do të realizoheshin. Axhenda iu dërgua paraprakisht edhe institucionit. Përpara vizitës në institucion grupi i vlerësimit të jashtëm realizoi një takim me kordinatorin e ASCAL, ku u diskutuan elementë të vlerësimit të programit.

Vizita dy ditore në institucion u zhvillua në datat 9 dhe 10 Maj 2022. Gjatë kësaj vizite, GVJ u takua me: Drejtues të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”, Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjës të Departamentit që mbulon programin e studimit; grupin e vlerësimit të brendshëm; pedagogët e aktivizuar në këtë program studimi; studentë të këtij programi studimi, përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të zyrës së Kurrikulës, përfaqësues të zyrës së Projekteve, përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerezore, përfaqësues të zyrës së Shërbimit të Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u vizituan ambjentet e institucionit ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, si edhe ambjentet e bibliotekës. Pas vizitës në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm diskutoi për çështje dhe problematika që dolën gjatë shqyrtimit dhe analizës të materialeve të paraqitura nga institucioni, diskutimeve gjatë ditëve të takimit, si dhe shqyrtimit dhe analizës së materialeve shtesë që iu kërkuan institucionit në ditën e dytë të vizitës. Më tej ky grup filloi punën për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm. Në përfundim të këtij procesi, grupi përgatiti dhe dorëzoi draft raportin tek kordinatori teknik i ASCAL.


Më datë 28.09.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 87/110 Prot., datë 28.09.2022, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 13.10.2022, dhe me shkresë zyrtare Nr. 120/27 Prot., datë 13.10.2022, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:



1. Lidhur me komentin e institucionit për shkallën e përmbushjes së rekomandimeve nga akreditimi i parë, GVJ e ka mbështetur vlerësimin duke marrë në konsideratë kualifikimin e stafit, ngarkesën vjetore dhe numrin e lëndëve që mbulojnë. Gjetjet janë përfshirë në raport. Sipas <sup>8</sup> evidencës 25 rezulton që në programin e studimit në të tre vitet akademike ka patur angazhim të personelit akademik që nuk ka patur kualifikimin e ciklit pasardhës.). **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi II.3 / Kriteri 3 , GVJ i qëndron rekomandimit të dhënë dhe korigjon vetëm referencën sipas regullores në lidhje me mesataren 8.5. Mbështetur në evidencën numër 27 rezulton që të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi te vite akademike e kanë patur mesataren në hyrje nën 7 dhe pjesa më e madhe e studentëve janë diplomuar me Provim të Përgjithshëm Përfundimtar. Këto evidenca mbështesin rekomandimin e GVJ. Rekomandimi nuk ndikon në shkallën e përmbushjes për Standardi II.3. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi II.4 / Kriteri 3 , GVJ i qëndron rekomandimit mbështetur dhe në referencat e dhëna më sipër. Rekomandimi nuk ndikon në shkallën e përmbushjes për Standardi II.4. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
4. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi II.6 / Kriteri 3 , GVJ sqaron si mëposhtë: Standardi II.6 / Kriteri 3 lidhet me ndikimin që kanë patur konsultimet me studentët në përmirësimin e programit të studimit. Evidencat e IAL mbi veprimtarinë e Bordit të Tregut janë reflektuar në RVJ. Nuk bëhet fjalë për mungesë evidencash, por për rezultate, që lidhen me ndryshime/përmirësime në PS dhe janë mbështetur tek rekomandimet e studentëve. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
5. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi IV.5 / Kriteri 5 , GVJ ka dhënë gjykimin e tij mbi rolin e sistemit të menaxhimit në monitorimin e aktivitetit të përditshëm, i cili është i njëjtë me vlerësimin në RVB. Në këtë kriter nuk janë dhënë vlerësime mbi mënyrën e matjes së performancës së stafit. Gjetja e GVJ nuk ka ndikuar në vlerësim për Standardi IV.5. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
6. Lidhur me komentet e institucionit për Standardi I.3 / Kriteri 5; Standardi I.5 / Kriteri 6; Standardi VI.2 / Kriteri 5; Standardi VI.5 / Kriteri 3, GVJ konstaton që IAL nuk ka bërë komente mbi vlerësimin, por ka përcjellë informacion mbi reformën për mënyrat e raportimit. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

<sup>8</sup> 25. Ngarkesa e personelit akademik te programit (tabela 4)






**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional "Menaxhim Biznesi", me profile: "Menaxhimi i SME- ve", "Menaxhimi i Burimeve Njerezore", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh", "Administrim Territori"**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë "Master profesional" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Në të gjitha dokumentat strategjik dhe statutin e IAL-së është përcaktuar qartë vizioni i institucionit për të ofruar edukim dhe kërkim të standardeve evropiane. UET synon gjithashtu kthimin në një qendër ekselence që të japë produkt cilësor kërkimor me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me ndikim rajonal. Vizioni dhe objektivat strategjike të institucionit reflektohen në planet strategjike për zhvillimin e programit të studimit. GVJ mbështetur në të gjitha dokumentat strategjik të IAL dhe takimin me drejtuesit e institucionit konkludon që UET ofron PS që mbështeten dhe mbrojnë vlerat dhe interesat kombëtare. Nga këto programe përfiton e gjithë shoqëria në nivel rajonal dhe kombëtar.</p> <p>[Ref. 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025, fq. Pika 1.1, fq.1; Ref.2. Statuti i UET, neni 6, pika 6.1, fq. 3; Ref. 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025, fq.2]</p>
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>UET ofron disa programe studimi në fushën e ekonomisë, të cilat janë fusha të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë kombëtare dhe ku punësohen aktualisht një pjesë e rëndësishme e studentëve të diplomuar. Në vizionin e miratuar nga institucioni theksohet që UET synon të punoj për thellimin e traditave më të mira universitare shqiptare. PS-t të ofruara nga UET përputhen jo vetëm me planin strategjik të institucionit, por gjithashtu dhe me strategjinë kombëtare të arsimit 2021-2026, e cila e vë theksin në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë, përsosmërinë në mësimdhënie dhe kërkim dhe ndërlidhjen me tregun e punës. Si pjesë e PS studentët realizojnë projekte dhe detyra të orientuara drejt sfidave dhe nevojave të ekonomisë shqiptare. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në institucion konstatoi që IAL e mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në traditat më të mira akademike dhe kulturore të vendit</p> <p>[Ref. 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025, fq.2; Ref.2. Statuti i UET, neni 6, pika 6.1, fq. 3]</p>





<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit (FEBZH) është Njësi kryesore e UET dhe ofron 6 (gjashtë) programe të ciklit të dytë, nga të cilat 4 (katër) janë programe studimi "Master Profesional". Sipas Planit strategjik të PS Masteri Profesional në Menaxhim Biznesi me profile synon formimin e specialistëve me njohuri të plota në aspektet teorike dhe në aftësitë praktike aplikative në fushën e menaxhimit të bizneseve të vogla, të mesme e të mëdha. Ky synim i PS përputhet me misionin e institucionit për <i>tëi pajisë studentët me dije dhe njohuri aplikative bashkëkohore të fushës së menaxhimit, tëi aftësojë ata në zhvillimin strategjik të biznesit, të nxisë shpirtin sipërmarrës për iniciimin e bizneseve të reja, si dhe të zgjerojë nivelin e tyre të bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përmes praktikave të punës, programeve të shkëmbimit studentor, përfshirjes në projekte, etj</i>". GVJ mbështetur në dokumentacion dhe takimin me drejtuesit e Njesisë kryesore dhe Njesisë bazë në IAL konstatoi që programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit.</p> <p><i>[Ref. 26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse (Aneks_Tabela 3) fq. 1; Ref 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të studimit MP Menaxhim Biznesi, pika II, fq.2]</i></p>		
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Për të realizuar misionin strategjik UET ka përcaktuar si prioritet për pjesën e edukimit përshtatjen e kurrikulave me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut, si dhe rritjen e numrit të studentëve në programet që janë me rëndësi për ekonominë dhe konkurrueshmërinë e saj. GVJ mbështetur në dokumentacion e DVV dhe vizitën në IAL konstatoi që programi i studimit formon specialistë që kërkohen nga tregu i punës dhe mund të kontribuojnë në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë. PS është hartuar gjithashtu për të formuar specialist që mund të punësohen në sipërmarrje të ndryshme apo të vetëpunësohen, duke kontribuar në këtë mënyrë në përgatitjen e kapitalit human që kërkohet për zhvillimin e ekonomisë lokale dhe kombëtare.</p> <p><i>[Ref 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të studimit MP Menaxhim Biznesi, pika II, fq.2; Ref. 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025, fq.3]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi I.2</b>  <b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi të gjitha dokumentat strategjik të miratuara nga institucioni, si Plani Strategjik 2015 – 2020; Plani Strategjik UET 2021-2025, Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të studimit dhe konstatoi që PS “Master Profesional në menaxhim me profile” është konceptuar në harmoni me vizionin dhe misionin e UET-së. Qëllimi dhe objektivat e PS janë në përputhje me qëllimet dhe objektivat strategjike të zhvillimit të institucionit.</p> <p><i>[Ref. 3. Plani Strategjik 2015 – 2020; Ref. 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025; Ref 4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit MP Menaxhim Biznesi]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në nenin 6 të statutin të UET-së janë përcaktuar drejtimit prioritar akademike të cilat janë në fushën ekonomike, juridike, shkencat shoqërore-politike, të edukimit dhe të teknologjisë së informacionit. Aktualisht oferta e UET është rritur. IAL përbëhet nga 5 Njësi kryesore të cilat ofrojnë programe studimi të cikleve të ndryshme. GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin në DVV dhe gjatë takimit me drejtuesit e Njësisë bazë dhe Njësisë kryesore konstatoi se IAL ka përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike në statut, rregullore dhe dokumentat strategjike. PS “Master Profesional në Menaxhim Biznesi” është hartuar dhe zbatohet në përputhje me aktet që rregullojnë veprimtarinë e IAL-së dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti i UET, neni 6, pika 6.1, fq. 3; Ref. 5. Rregullore e UET, Kreu II, neni 4, fq.2; Ref. 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025, pika II.1.4, fq.5]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi studimit " Master Profesional në Menaxhim Biznesi" është program studimi i ciklit të dytë, me nivel kualifikimi 7 sipas kornizës shqiptare të kualifikimit. PS është organizuar në dy semestra dhe realizohet me 60 ECTS. Përmbajtja, struktura dhe organizimi i PS është në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi për programet e studimit të ciklit të dytë. Statuti i IAL-së dhe dokumentat e PS (plani mësimor i programit dhe suplementi i diplomës) japin të dhëna të plota mbi organizimin dhe përmbajtjen e tij. Nga shqyrtimi i këtyre dokumentave GVJ konstatoi se PS është organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti i UET, neni 32, pika 32.4, fq. 21; Ref. 5. Rregullore e UET, Kreu II, neni 3, pika 3.8, fq.2; Ref. 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip); Ref. 15. Modeli Diplome Modeli Suplementi për secilin profil]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Programi i studimit formon specialist që mund të punësohen në sipërmarrje të ndryshme apo të vetëpunësohen dhe është hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, një nga shtyllat e së cilës ishte investimi në kapitalin njerëzor dhe kohezioni social. Ky program studimi është gjithashtu në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, prioritetet e institucionit dhe është përshtatur me nevojat e tregut të punës në nivel kombëtar.</p>



	<p>GVJ konkludoi që hartimi i PS përputhet me objektivat strategjikë kombëtar të zhvillimit, mban në konsideratë interesin kombëtar dhe mbështetet në nevojat e tregut të punës.</p> <p>[Ref. 17. Studimi për tregun e punës për programin, fq.1; Ref. 2. Statuti i UET, neni 30, pika 30.4, fq.20]</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Objektivat e PS janë përcaktuar qartë në rregulloren e programit të studimit. Studentët që ndjekin këtë program marrin formim, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë. Ata pajisen kryesisht me njohuri teorike bazë dhe aftësim praktik për zbatimin e këtyre njohurive. Dijet dhe aftësitë që fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit paraqiten në mënyrë të detajuar në dokumentacionin e PS (syllabuset). Rezultatet e të nxëniet janë specifikuar gjithashtu për secilin nga profilet e programit të studimit në suplementin e diplomës. GVJ mbështetur në DVV dhe takimet me stafin gjatë vizitës konstatoi që PS ka objektiva të qarta për formimin e studentëve.</p> <p>[Ref. 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, pikat 3.3.1 dhe 3.3.2, fq. 2-3; Ref. 15. Modeli Diplome_Modeli Suplementi për secilin profil, pikat 4.2, 4.5, fq. 2-3]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>UET ka paraqitur në DVV një studim tregu të dedikuar për programin e studimit. Studimi është mbështetur kryesisht në publikimet zyrtare dhe në diskutimet e fokus grupeve të organizuara me antarë të bordit të tregut të punës të Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut. Në studim nuk ka të dhëna sasiore mbi punësimin e studentëve që janë diplomuar në këtë program studimi. Sipas statistikave të punësimit të studentëve të diplomuar rezulton që në vitin akademik 2019-2020 janë diplomuar 51 studentë, nga të cilët vetëm 44% kanë dhënë përgjigje mbi statusin e tyre të punësimit. 87.5% e studentëve që kanë dhënë përgjigje deklarojnë që janë të punësuar. Nga këta rezultojnë të punësuar në përputhje me diplomën 71.4%. Shkalla e punësimit në këtë program studimi është 7 pikë për qindje më e lartë se sa shkalla e punësimit të të diplomuarëve në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. GVJ sugjeron që studimet e tregut të punës duhet të mbështeten në një metodologji të caktuar, që të mundësoi krahasimin e të dhënave me studimin e mëparshëm dhe të bëjë parashikime për të ardhmen. Gjetjet dhe</p>



	<p><b>rekomandimet e fokus grupeve duhet të përpunohen dhe të përfshihen në raport në formë më të strukturuar.</b></p> <p><i>[Ref. 17. Studimi për tregun e punës për programin; Ref. 29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathëtsive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit iu jep studentëve mundësinë të marrin njohuri teorike bazë në fushën e menaxhimit, të aplikojnë njohuritë e marra në veprimtaritë praktike, i aftëson për të krahasuar modelet e ndryshme të biznesit dhe për të gjykuar mbi efektivitetin e tyre. GVJ pasi pa me kujdes DVV dhe të gjitha programet e lëndore (syllabuset) konkludoi që PS ofron dije të përshtatshme për ciklin e dytë të studimeve dhe gjithashtu i orienton studentët drejt aftësimit praktik, për të kaluar në tregun e punës. Në disa lëndë zgjerohen dhe thellohen njohuritë e marra në ciklin e parë, ndërsa në program janë përfshirë dhe lëndë që ndihmojnë në profilizimin e studentëve dhe zhvillimin e kompetencave për të punuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.</p> <p><i>[Ref. 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip; Ref. 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip); Ref. 19 Syllabuset e të gjitha lëndëve]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Ndërkombëtarizimi ka qënë dhe mbetet një prioritet strategjik për UET, duke synuar të bëhet një qëndër e rëndësishme dhe pikë referimi kombëtare dhe rajonale në bashkëpunimin akademik. PS është hartuar duke mbajtur në konsideratë këtë prioritet dhe programe të ngjashme të ofruara në institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Lëndët e detyruara janë të ngjashme me ato të programeve të tjera, ndërsa tek lëndët me zgjedhje programi krijon më shumë hapësira për specializim. Mbështetur në DVV, GVJ konstatoi që programi i studimit përafrohet me programe studimi të ofruara nga institucione ndërkombëtare në fushën e menaxhimit. Në rregulloren e programit të studimit është parashikuar gjithashtu mundësia e transferimeve nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, dhe lejohet transferimi i studentëve të UET në shkolla të tjera.</p> <p><i>[Ref. 3. Plani Strategjik 2015 – 2020, pika 6, fq. 7; Ref. Plani Strategjik 2021 – 2025, pika 6, fq. 9; Ref. 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, pika 9.1, fq. 6]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>UET ka 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite eksperiencë në fushën akademike, ofron programe në të tre ciklet e studimit dhe ka arritje në fushën e kërkimit shkencor dhe zbatimin e projekteve kërkimore. GVJ konstatoi që PS është hartuar në përputhje me Ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH" dhe aktet nënligjore në zbatim të ligjit, qëllimi i të cilit është të krijojë një sistem të unifikuar të arsimit të lartë, kërkimit shkencor në</p>



	<p>institucionet e arsimit të lartë, inovacionit bashkëkohor e konkurrues në hapësirën evropiane të arsimit të lartë<sup>9</sup>.</p>				
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Praktika profesionale është lëndë plotësuese në planin mësimor të programit të studimit në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". UET ka marrëveshje me disa sipërmarrje dhe institucione ku studentët mund të realizojnë praktikën profesionale. Rregullorja e programit të studimit parashikon mënyrën e organizimit, mbikëqyrjen dhe afatet e realizimit të saj. Elementë të aftësimin profesional përmbajnë dhe disa lëndë të planit mësimor ku studentët angazhohen në prezantimin e rasteve studimore dhe bëjnë detyra kursi. GVJ konstatoi që konceptimi dhe mënyra e organizimit të praktikës profesionale është në përputhje me objektivin e programit të studimit për aftësimin praktik të studentëve.</p> <p><i>[Ref. 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, pika 7, fq. 5; pika 3.3.1, fq.2; Ref. 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip); 32. Lista e Subjekteve dhe Institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale]</i></p>				
<p><b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacionin që përmban DVV dhe nga vizita në institucion konstatoi që IAL ofron dy lëndë të planit mësimor në gjuhën angleze; përkatësisht Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (Human Resource Management) dhe Aftësitë Manaxheriale (Managerial Skills). Këto dy lëndë janë në planin mësimor të Masterit të Shkencave dhe Masterit Profesional dhe mund të ofrohen në shqip dhe anglisht. Syllabuset e lëndëve dhe literatura ofrohen në shqip dhe anglisht. UET ka përcaktuar si objektiv strategjik që deri në vitin 2025 të ofrohet në gjuhën angleze 25% e kurrikulës mësimore për çdo program studimi.</p> <p><i>[Ref. 19. Human Resources Management; Ref. 19. Managerial skills; Ref. 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025, pika 1.2, fq.4]</i></p>				
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacionin që përmban DVV dhe nga vizita në institucion konstatoi që oferta akademike e UET është orientuar në përgjithësi nga kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit "Master Profesional në Menaxhim Biznesi" është një program me profile dhe ka përshtatur përmbajtjen dhe numrin e profileve në varësi të kërkesave. Aktualisht ka katër profile aktive, nga pesë profile të miratuara. Profilet ndryshojnë nga njëri tjetri me 18 ECTS ose 30% të planit mësimor.</p> <p><i>[Ref. 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip); Ref. 52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës, (aneks tab.11); Ref. 52.1 Profilet MP Menaxhim Biznesi, Nr.Prot. 78]</i></p>				
	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përbushet pjesërisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		

<sup>9</sup> Ligji nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH", neni 2, pika c.



Shkalla e përmbushjes së standardit

X

#### Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësies kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit është një nga Njësitet kryesore të UET-së që e ka filluar veprimtarinë e vet në vitet e para të hapjes së këtij institucioni në vitin akademik 2008-2009. Fakulteti ka krijuar profilin e tij dhe është konsoliduar gradualisht për tëiu përgjigjur zhvillime kombëtare në përgjithësi dhe atyre në fushën e ekonomisë dhe biznesit në veçanti. PS ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut dhe ngarkesa mësimore mbulohet kryesisht nga personeli akademik i kësaj Njësie bazë. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut ofron 8(tetë) programe studimi, nga të cilat 3 (tre) janë programe të ciklit të dytë.

Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit ka patur gjithsej 40 pedagogë për vitin akademik 2020-2021, nga të cilët **30 janë pedagogë efektiv (PAE)** nga ku: 3 (tre) kanë titullin “Profesorë”, 5 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 10 (dhjetë) kanë gradën Dr, 1 (një) është Dr në process, 11 (njëmbëdhjetë) Asistent Lektorë me Msc; dhe **10 (dhjetë) pedagogë me kontratë (PAK)** nga ku 1 (një) ka titullin “Profesorë”, 2 (dy) kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 3 (tre) kanë gradën Dr./PhD, 2 (dy) janë Dr në process dhe 2 (dy) Asistent Lektorë me Msc. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut ka patur 8 (tetë) PAE, nga të cilët 2 (dy) “Profesorë”, 2 (dy) “Prof. Asociuar”, 3 (tre) kanë gradën Dr. dhe 1 (një) Asistent Lektorë me Msc

Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në vitin akademik 2020-2021, sipas evidencës rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie **11 (njëmbëdhjetë) pedagogë** gjithsej, ku 7 (shtatë) janë **PAE**, nga të cilët 2 (dy) me titull Profesor, 1 (një) Prof.Asoc, 3 (tre) me gradën Dr/PhD, 1 (një) Msc. dhe 4 (katër) **PAK** nga të cilët 1 (një) Prof.Asoc., 2 (dy) me gradën Dr/PhD. 1 (një) Msc.

Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 rezultoi 1.75/1 ose 63.6% janë PAE dhe me 36.4% janë PAK.

71.4% e ngarkesës në këtë program është mbuluar nga PAE në vitin akademik 2020-2021. Në vitin akademik 2021-2022 mësimdhënia mbulohet në masën 92.9% nga PAE, i gjithë personeli është me tituj dhe grada shkencore, dhe vetëm një është doktorantë (Dr. në proces). Evidencat e dorëzuara dëshmojnë që mësimdhënia në këtë PS realizohet nga personel akademik i kualifikuar dhe i angazhuar në mësimdhënie në përputhje me gradat dhe titujt akademikë. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia bazë ka



	<p>kapacitetet, përvojën dhe burimet e nevojshme në fushën akademike për të ofruar PS-it, por duhet të evitohet dhe ndonjë rast kur angazhon në mësimdhënie personel që nuk ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës<sup>10</sup>.</p> <p>[Ref. 26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësi përgjegjëse (Aneks_Tabela 3); Ref. 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks - MP Menaxhim Biznesi, tabela 1.1 dhe 1.2, fq.1-2; Ref. 25. Ngarkesa e personelit akademik te programit (tabela 4), tabelat 12.3 dhe 12.4, fq. 6-7]</p>								
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi” është program studimi i ciklit të dytë, që i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit i përket fushës së shkencave ekonomike, me drejtim specifik në Biznes. GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit (Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit).</p> <p>[Ref. 2. Statuti i UET, neni 6, pika 6.1, fq. 3]</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut. Ky Departament ofron vetëm programe studimi në fushën e Menaxhimit dhe Marketingut në të gjitha ciklet e studimit. GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë (Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut), përgjegjës për këtë PS.</p> <p>[Ref. 26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësi përgjegjëse (Aneks_Tabela 3)]</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi” përputhet tërësisht me profilin e institucionit.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

<sup>10</sup> Ligji 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH", neni 59, pika 6



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Detyrat dhe përgjegjësitë për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e PS janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e IAL-së, si dhe në rregulloren e PS. Përgjegjësitë janë të ndara, por njëkohësisht dhe të harmonizuara midis strukturave organizative, organeve vendimmarrëse dhe autoriteteve drejtuese (Senatit Akademik, Njesisë kryesore dhe Njesisë bazë). Njësia bazë ka rolin dhe peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e PS. GVJ konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara më së miri në të gjitha aktet rregullatore të institucionit. Mbarëvajtja e programit analizohet në mënyrë periodike, dhe secila njësi raporton për detyrat e saj.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti i UET, neni 14, pika 14.2; neni 15, pika 15.2, fq. 6; Ref. 5. Rregullore e UET, nenet 16-22, fq. 5-7; Ref. 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar 94 marrëveshje bashkëpunimi me universitete Evropiane dhe të Ballkanit, të cilat janë shfrytëzuar për realizimin e objektivave të procesit mësimor, zhvillimin e punës kërkimore shkencore, shkëmbimin e përvojave dhe mobilitetin e personelit dhe studentëve. Në periudhën 2018-2022, UET ka nënshkruar gjithashtu 46 marrëveshje bashkëpunimi me institucione private dhe publike, sipërmarrje të fushave të ndryshme me qëllim që të mbështesë arritjen e objektivave të programit të studimit dhe realizimin e praktikave të studentëve. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se Njësia bazë ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë e bashkëpunimit për të realizuar objektivat e përcaktuara për procesin mësimor.</p> <p><i>[Ref. 32. Lista e Subjekteve dhe Institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale; Ref. 34. Marrëveshjet e bashkëpunimit UET]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Realizimi i këtij program studimi nuk ka nevojë për marrëveshje të posaçme. GVJ konstatoi mbështetur në DVV dhe gjatë vizitës në institucion që UET ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione dhe sipërmarrje të ndryshme, ku realizimi i praktikave, punësimi, kualifikimet dhe specializimi janë objekt i bashkëpunimit. Marrëveshjet e lidhura dhe objekti i bashkëpunimit që ato kanë janë të përshtatshme për programin e studimit.</p> <p><i>[Ref. 32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale; Ref. 34.1 Marrëveshje bashkëpunimi UET dhe Plaza Tirana; Ref. 34.3 Memorandum bashkëpunimi UET dhe Bashkia Tiranë]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës</p>	<p>Përgjegjësinë kryesore për realizimin e praktikës e ka Njësia bazë, e cila bashkëpunon me Zyrën e Këshillimit të Karrierës. Njësia bazë përzgjedh institucionet ku do të kryhet praktika, cakton pedagogun përgjegjës për mbikëqyrjen e praktikës, shpërndan dhe mbledh dokumentacionin e</p>



specifike të programeve të studimit që ofron.	<p>praktikës profesionale. GVJ konstatoi që në memorandumet e bashkëpunimit që ndodhen në DVV është përfshirë ndër të tjera dhe roli i sipërmarrjeve në mbikëqyrjen e praktikës profesionale.</p> <p>[Ref. 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale, pika B.1.3, fq. 28]</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>GVJ konstatoi se strukturat ndihmës akademike të institucionit ofrojnë trajnime për zhvillimin e karrierës dhe riorientimin në tregun e punës, por nuk ofrohen trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në këtë program studimi.</p> <p>[Ref. 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Ref. 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</p>			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut ka hartuar dy raporte për periudhën 2018-2022. Në një raport janë analizuar arritjet e objektivave formues dhe në raportin tjetër përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të PS. <b>GVJ konstatoi që në të dy raportet ka shumë informacion, por duhet më shumë analizë mbi arritjet, problematikat nëse ka dhe rekomandimet për të rritur përfitimet nga bashkëpunimet në të ardhmen apo për të gjetur forma të reja bashkëpunimi.</b></p> <p>[Ref. 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; Ref. 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese]</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian	Programi Studimit "Master Profesional në Menaxhim Biznes" është organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se PS është organizuar në 2 (dy) semestra me një kohëzgjatje 1 (një) vit akademik.



<p>të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Çdo semestër ka ngarkesë mësimore prej 30 ECTS. Plani mësimor është organizuar në lëndë, ku çdo lëndë vlerësohet me 6 ECTS. 1 ECTS është llogaritur me 25 orë. Plani mësimor përbëhet nga 7 lëndë, nga të cilat 4 janë të detyrueshme dhe 3 mund të zgjidhen nga një listë lëndësh sipas profilit që studentët kanë zgjedhur, praktika profesionale me 6 ECTS dhe si punimi i diplomës/provim i përgjithshëm formimi me 12 ECTS.</p> <p><i>[Ref. 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip); Ref. 14.2 Plani mesimor i programit shqip]</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit synon formimin e specialistëve, me njohuri të plota teorike dhe aftësi praktike në katër drejtime: në fushën e menaxhimit të sipërmarrjeve, menaxhimit të burimeve njerëzore, menaxhimit dhe vlerësimin e projekteve dhe administrimin e territorit. Referuar përmbajtjes së planit mësimor konstatohet një përzgjedhje e kujdesshme e lëndëve të detyruara dhe atyre me zgjedhje. Studentët mund të zgjedhin tre lëndë dhe kjo mundëson profilizimin të tyre një nga katër profilet e programit të studimit. GVJ është e mendimit se PS i shërben formimit të shprehive të veçanta në një nga profilet, dhe krijon mundësi më të mëdha punësimi në institucione qendrore dhe vendore, apo në sipërmarrje private, etj.</p> <p><i>[Ref. 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të studimit MP Menaxhim Biznesi, fq. 1; Ref. 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip)]</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ mbasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin që ndodhej në DVV si plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit, kurrikula e programit të studimit, plani mësimor, syllabuset e lëndëve, si dhe nga informacioni i siguruar nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, personelin akademik dhe studentët e programit të studimit, është i mendimit se ky program studimi iu ofron studentëve njohuri të thelluara në disa nga fushat e menaxhimit, nxit mendimin kritik mbi metodat inovative të menaxhimit dhe i aftëson studentët për punë të pavarur në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.</p> <p><i>[Ref. 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të studimit MP Menaxhim Biznesi; Ref. 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip); Ref. 14.2 Plani mësimor i programit shqip; Ref. 19 Syllabuset]</i></p>
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Referuar të gjithë dokumentacionit në DVV, GVJ konstatoi që PS thellon njohuritë e studentëve në fushën e menaxhimit, i aftëson ata për të analizuar strategji të zhvillimit të sipërmarrjeve në sektorë të ndryshëm dhe për të zbatuar ato, krijon gjithashtu mundësi që studentët të zhvillojnë aftësi të tyre kërkimore dhe praktike duke punuar në projekte individuale.</p> <p><i>[Ref. 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të studimit MP Menaxhim Biznesi; Ref. 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip); Ref. 14.2 Plani mësimor i programit shqip; Ref. 19 Syllabuset]</i></p>



<p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ mbas shqyrtimit të elementëve që përbëjnë strukturën e programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi, konstatoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• PS ka të përcaktuara dhe të deklaruara objektivat formuese që synohen të arrihen si dhe kompetencat profesionale që synohet të fitojnë studentët në përmbyllje të studimeve të tyre.</li> <li>• Programi është i organizuar në 2 (dy) semestra me një kohëzgjatje 1 (një) vit akademik, ku çdo semester ka ngarkesë mësimore prej 30 ECTS me një total prej 60 ECTS;</li> <li>• Plani mësimor përmban 7(shtatë) lëndë (4 (katër) të detyruara dhe 3 (tre) me zgjedhje), të cilat zhvillohen të shpërndara në dy semestra (4 (katër) lëndë në semestrin e parë dhe 3 (tre) në semestrin e dytë me 6 ETCS secila), praktika profesionale zhvillohet në semestrin e dytë, ndërsa punimi i diplomës me 12 ECTS shtrihet gjatë gjithë vitit.</li> <li>• Ngarkesa javore është 4 orë/në javë për çdo lëndë. Ngarkesa semestrale në auditor është 17 orë në semestrin e parë (12 orë lëndët, 1 orë punimi diplomës) dhe 13 orë në semestrin e dytë (12 orë lëndët, 1 orë punimi diplomës). Praktika profesionale është 40 orë në java në auditor, ose 120 orë në total.</li> <li>• Syllabuset e lëndëve janë në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca nr.2). Ato janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat dhe rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat dhe përmbajtja e shkurtuar e tyre, literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar, emrin e titullarit, numrin e krediteve, mënyrën e vlerësimit, ngarkesën leksion/seminar dhe ngarkesën e punës së studentit.</li> </ul> <p><i>[Ref. 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip); Ref. 14.2 Plani mësimor i programit shqip; Ref. 19 Syllabuset]</i></p>
<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në planin mësimor gjenden të gjitha ndarjet sipas veprimtarive formuese nga A-E dhe lëndët e përfshira në secilën kategori. Veprimtaritë formuese janë të përcaktuara si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- lëndët bazë (kategoria A) kanë 6 ECTS ose 10.0% të krediteve,</li> <li>- lëndët karakterizuese (kategoria B) kanë 18 ECTS, ose 30.0 % të krediteve,</li> <li>- lëndët integruese (kategoria C) kanë 18 ECTS që zënë 30% të krediteve,</li> <li>- lëndët plotësuese (kategoria D) kanë 6 ECTS ose 10.0% të krediteve,</li> <li>- kategoria E e detyrimeve përmblylëse përmban 12 ECTS ose 20.0% të krediteve të PS.</li> </ul> <p>GVJ konstatoi se përqindja totale e lëndëve të kategorive nga A në E është më në përputhje me kërkesat e VKM 41, datë. 24.01.2018.</p>



	[Ref. 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip); Ref. 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese-MP Menaxhim Biznesi (Aneks_Tabela 9)]		
<b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Programi studimit parashikon në grupin e lëndëve plotësuese praktikën profesionale me 6 ECTS, dhe kjo ngarkesë është në përputhje me kërkesat e VKM 41, datë. 24.01.2018 që parashikon 10.0% të krediteve për lëndët plotësuese. Praktika parashikon 150 orë pune për studentin nga të cilat 8 orë realizohen në auditor, 120 orë në një institucion ose sipërmarrje dhe 22 orë janë punë e pavaruar. GVJ konstatoi që mënyra e zhvillimit, mbikëqyrja dhe vlerësimi praktikës janë të parashikuara në rregulloren e IAL-së dhe rregulloren e programit të studimit.		
	[Ref. 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese-MP Menaxhim Biznesi (Aneks_Tabela 9), Ref. 5. Rregullore e UET; Ref. 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, pika 7, fq. 4]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

## Standardi II.2

### Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Referuar të dhënave në sistemin e informacionit të ASCAL, GVJ konstatoi se Institucioni është akredituar në nivel institucional si "Universiteti Europian i Tiranës", me tre fakultete, me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017, deri më 06/04/2022. Pas riorganizimit të tre Njësive kryesore dhe hapjes së dy njësive të reja Bordi Akreditimit ka akredituar institucionin me vendim Nr. 46, datë 05.07.2019, deri më 06/04/2022. Institucioni është në process riakreditimi periodik institucional <sup>11</sup> .  Programi i studimit është akredituar për herë të parë si program studimi i ciklit të dytë "Master Profesional" me VBA Nr. 32, datë 13.07.2018 (i rishikuar me VBA Nr. 32/1, datë 07.12.2018) me kohëzgjatje për 4 (katër) vite në tre profile.  [ ] <a href="https://ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara">https://ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara</a>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit është Njësi kryesore dhe është organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 80/2015, neni 23, pika 2. Ai përbëhet nga 3 Njësi bazë (2 departamente dhe 1 (një) qendër:  1. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut 2. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës 3. Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

<sup>11</sup> <https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-5-korrik-2019-2>



	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut ofron 8 programe studimi, nga të cilat 3 (tre) në ciklin e dytë. Njësia bashkëpunon gjithashtu me njësitë e tjera bazë për realizimin e programeve të tyre të studimit të ciklit të parë, të dytë dhe programet profesionale jouniversitare.</p> <p>Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për PS janë të përcaktuara në statutin e IAL-së dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit dhe Përgjegjësi i Departamentit kanë titullin akademik “Profesor Asociuar”<sup>12</sup>. GVJ konstatoi që organizimi dhe struktura akademike përmbushin detyrimet ligjore.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti i UET, nenet 13-15, fq. 6-7; Ref. 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks - MP Menaxhim Biznesi]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Në vitin e fundit akademik 2021-2022, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit ka në përbërje të tij 31 (<b>tridhjetë e një</b>) pedagogë gjithsej, të cilët janë të gjithë personel akademik efektiv (PAE).</p> <p>Personeli akademik sipas departamenteve për këtë vit akademik është si më poshtë:</p> <p><b><u>Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës:</u></b></p> <p>13 (trembëdhjetë) PAE, ndër të cilët 7 (shtatë) me tituj / grada</p> <p><b><u>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 9 (nëntë) PAE, ndër të cilët 7 (shtatë) me tituj / grada;</li> </ul> <p><b><u>Qendra për Zhvillimin e Qëndryshëm:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 8 (tetë) PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada;</li> </ul> <p>Në vitin akademik 2020-2021, Fakulteti ka patur <b>40 (dyzetë) pedagogë gjithsej</b>, ndër të cilët, <b>30 (tridhjetë)</b> janë personel akademik efektiv (PAE) dhe <b>10 (dhjetë)</b> personel akademik me kontratë (PAK).</p> <p>Personeli akademik i Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut që është përgjegjës për programin e studimit për katër vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik <b>2018-2019, (9 PAE /7 PAK)</b>, nga këta me grada/tituj shkencore <b>8/4</b>;</p> <p>Për vitin akademik <b>2019-2020, (10 PAE /5 PAK)</b>, nga këta me grada/tituj shkencore <b>8/2</b>;</p> <p>Për vitin akademik <b>2020-2021, (8 PAE /6 PAK)</b> nga këta me grada/tituj shkencore <b>7/4</b>.</p> <p>Për vitin akademik <b>2021-2022, (9 PAE /0 PAK)</b> nga këta me grada/tituj shkencore <b>7/0</b>.</p>

<sup>12</sup> Në përputhje me Ligjin 80/2015, neni 42, pika 3 dhe neni 45, pika 3



	<p>Përsa më sipër GVJ konstatoi se të tre njësitë bazë, plotësojnë detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Për sa më sipër Njësia kryesore dhe Njësia bazë përgjegjëse për programin (Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut), përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik</li> <li>- organizimin dhe strukturën akademike.</li> </ul> <p><i>[Ref. 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks - MP Menaxhim Biznesi, tabelat 1.1, 1.2, 2.1, 2.2 dhe 2.3]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Mbështetur në analizën e kriterëve 1, 2 dhe 3 GVJ konkludon që Njësia kryesore dhe Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Praktikat profesionale realizohen pranë sipërmarrjeve dhe në institucione të ndryshme vendore/qëndrore. Njësia bazë angazhon pedagogë të departamentit për mbarëvajtjen e praktikave profesionale. Praktika mbikëqyret gjithashtu nga një person, personel i institucionit ku kryehet praktika dhe studenti plotëson një formular veyvlerësimi në fund të praktikës. Institucioni ka një politikë tjetër për praktikën, në lidhje me studentët që janë në marrëdhënie pune. Studentët që punojnë me kohë të plotë ose të pjesëshme gjatë periudhës që kanë detyrim të kryejnë praktikën profesionale, mund të konsiderohet puna si plotësim i detyrimit për praktikë në disa raste. <b>GVJ rekomandon që për këto raste duhet të parashikohet një detyrim tjetër në planin mësimor në kategorinë e lëndëve plotësuese.</b></p> <p><i>[Ref. 32.2 B-I-4 Formulari i vetvlerësimit të praktikës (nga Studenti); Ref. 32. Lista e Subjekteve dhe Institucioneve bashkepunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale; Ref. 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita në institucion që Dekani ka emëruar një personel akademik në rolin e koordinatorit të programit. Në aneksin e vendimit të dekanatit janë përcaktuar detyrat e koordinatorit, të cilat lidhen kryesisht me ecurinë e zhvillimit të programit mësimor dhe praktikave profesionale.<sup>13</sup></p> <p><i>[Ref. 36. Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit_Detyrat e koordinatorit, fq. 1; Ref. 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe</p>	<p>GVJ konstatoi nga DVV që një nga detyrat e koordinatorit është hartimi i raportit periodik vjetor mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënimit dhe aftësimin profesional, i cili duhet të analizohet në mbledhjen e departamentit</p>

<sup>13</sup> Emri i koordinatorit në RVB nuk përputhet me emrin e vendosur në Vendimin e Dekanatit



dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	përkatës. Pjesë e detyrave të tij është dhe dokumenimi dhe ruajtja e informacionit që ka të bëjë me realizimin e programit të studimit.  [Ref. 36. Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit Detyrat e koordinatorit, fq. 2]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X


<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Referuar DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit dhe Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut disponojnë informacion të plotë lidhur me PS "Master Profesional në Menaxhim Biznesi", siç janë rregullore e programit të studimit, kuotat e pranimit, plani mësimor, informacion mbi strukturën akademike, syllabuset e lëndëve, personelin akademik të programit të studimit dhe CV e tyre, cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, etj. I gjithë informacioni që lidhet me programin e studimit mund të aksesohet nga personeli akademik përmes rrjetit të brendshëm të institucionit dhe për studentët përmes sistemit LMS. Një pjesë e këtij informacioni është gjithashtu e publikuar në faqen e UET-së.  [Ref. 46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS; Ref. 46.2 UET LMS - Guidë për pedagogun; Ref. 46.3 UET_LMS_Guidë për studentët]
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Planit mësimor është organizuar në 7 lëndë (nga të cilat 4 të detyrueshme dhe 3 me zgjedhje), praktika profesionale si lëndë plotësuese dhe punimi i diplomës/provim i përgjithshëm formimi si detyrim përmblyës për këtë program studimi. GVJ konstatoi që organizimi i programit të studimit në lëndë dhe aktivitete formuese është në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi si Ligji 80/2015 neni 75, pika 6 dhe VKM Nr. 41 <sup>14</sup> .  [Ref. 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip); Ref. 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip]
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi studimit është i organizuar në 2 (dy) semestra me një kohëzgjatje 1 (një) vit akademik. Ngarkesa mësimore në çdo semestër është 30 ECTS, në total 60 ECTS. Studentit i ofrohen 4 lëndë në semestrin e parë dhe 3 lëndë në semestrin e dytë, punimi diplomës shtrihet në dy semestra dhe praktika profesionale zhvillohet në semestrin e dytë. Lëndët janë shpërndarë në planin mësimor sipas llojit të veprimtarive (nga A në E). GVJ konstatoi që ndarja e lëndëve në semestra dhe vite akademike


<sup>14</sup> Ligji Nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH dhe VKM Nr. 41, data 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë



	<p>është në përputhje me aktet ligjore në fuqi. <i>Megjithatë GVJ sugjeron që punimi i diplomës të realizohet i gjithë në semestrin e dytë, pasi në semestrin e parë puna e pavarur për punimin e diplomës nuk mund të realizohet në mënyrë efektive, pasi studentët nuk kanë nivelin e njohurive të kërkuara. Ky rekomandim mbështet dhe në rregulloren e programit të studimit që i jep të drejtë për të aplikuar për punim diplome studentëve me notë mesatare në hyrje së paku 7.5. Rregullorja mësimore parashikon gjithashtu që mbrojtja të bëhet përmes një punimi diplome vetëm për studentët me mesatare mbi 8.5 dhe punimi të jetë një projekt profesional me karakter aplikativ/praktik. Ndërsa studentët e tjerë duhet të japin një provim të përgjithshëm përfundimtar.</i></p> <p>[Ref. 14.2 Plani mesimor i programit shqip; Ref. 5. Rregullore e UET, neni 39, pika 39.1, fq. 10; Ref. 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, neni 8, pika 8.1, fq. 5]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, numrin e provimeve. Çdo lëndë vlerësohet me 6 ECTS, zhvillohet 4 orë/javë në auditor (ose 60 orë në total) dhe 90 orë jashtë auditorit (studim individual). 1 ECTS = 25 orë mësimore. Në rregulloren e programit si dhe në syllabuset e lëndëve, jepet gjithashtu informacion i hollësishëm për frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm të dijeve, etj. Frekuentimi është i detyrueshëm në masën 80% për të gjitha veprimtaritë. Vlerësimi i dijeve bëhet me pikë dhe konvertohet në notë ku nota më e ulët kaluase është 5 (pesa). Vlerësimi përfundimtar kombinon disa elementë si diskutim në klasë, detyra, provim i pjesshëm dhe përfundimtar, dhe pesha e secilit elementë përcaktohet nga tipologjia e lëndës. GVJ konstatoi që plani mësimor është hartuar në përputhje me përcaktimet ligjore<sup>15</sup>.</p> <p>[Ref. Ref. 14.2 Plani mesimor i programit shqip; Ref. 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, nenet 4, 5 dhe 6, fq. 3-5; Ref. 19. Syllabuset; Shënimet e vizitës në institucion ]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullore mësimore dhe rregullore e programit të studimit përmbajnë kriteret e përgjithshme të pranimit në programet e ciklit të dytë. GVJ nuk konstatoi vendosjen e kriterëve specifike për pranimin në programin e studimit Master Profesional. GVJ konstatoi gjithashtu që nota mesatare në hyrje është rritur në vitin akademik 2020-2021 krahasuar me vitet paraardhëse (7.31/10) për këtë program studimi. Numri maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes përcaktohen me vendim të Senatit Akademik dhe bëhen publike çdo fillim viti akademik para fillimit të regjistrimeve. Rregulloret përmbajnë të gjitha procedurat që ndiqen nëse transferohen studimet. IAL ka procedura</p>

<sup>15</sup> VKM Nr. 41, data 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë



24  




	<p>të përcaktuara qartë për pranimin e studentëve dhe transferimin e studimeve.</p> <p>[Ref. 5. Rregullore e UET, neni 11, fq. 4, neni 35, fq. 10; Ref. 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, neni 2, fq. 1, neni 9, fq.6; Ref. 27. MP Menaxhim Biznesi _Cilesia ne hyrje dhe dalje, fq.1; Ref. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit te studenteve; Ref. 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin]</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>PS përbëhet nga 4 lëndë të detyrueshme dhe 10 lëndë me zgjedhje. GVJ konstatoi që UET ka një procedurë të miratuar për hartimin e programeve të lëndës, e cila i vjen në ndihmë personelit akademik për hartimin e syllbuseve të reja apo rishikimin e atyre ekzistuese. Sipas DVV rezultoni që formati i syllabuseve është i standartizuar në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 në shqip dhe anglisht. Syllabuset kanë informacion që lidhet me përmbajtjen, rezultatet e të nxënit dhe objektivat e lëndës, konceptet bazë që do të trajtohen, temat që do të zhvillohen çdo javë, literaturën e detyrueshme dhe literaturën e rekomanduar, emrin e titullarit, numrin e krediteve, ngarkesën javore, detyrimet lëndore dhe format e vlerësimit. Disa syllabuse që lidhen me këtë program studimi janë dhe në anglisht.</p> <p>[Ref. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës; Ref. 19.1 Formati i Syllabusit (shqip anglisht)]</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>UET ka procedura të miratuara për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Ndryshimet propozohen nga Departamenti dhe dërgohen në Dekanat. Nëse Dekanati është dakort me propozimin e kalon për miratim në Senatit Akademik, pasi është konsultuar paraprakisht me Zyrën e Kurrikulave. GVJ konstatoi se nga akreditimi i parë deri në riakreditim programi ka ndryshuar me 12 ECTS ose 10% pasi është riorganizuar sipas kërkesave të VKM Nr. 41, data 24.01. 2018 nga një program me tre profile, në një program me pesë profile Ndryshimet në planin mësimor, si dhe ndryshimet e syllabuseve, të literaturës, bëhen përpara fillimit të vitit akademik. Dosja me ndryshimet arkivohet në Departament dhe në Zyrën e Kurrikulave.</p> <p>[Ref. 13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyres se Kurrikulave; EVIII4.1 dhe EVIII4.3, fq. 88-89; Ref. 52. Procedura per ndryshimin e kurrikules, (aneks tab.11)]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të**



<b>Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ konstatoi që kohëzgjatja e studimeve (1 vit akademik ose 60 ECTS), numri i orëve për kredit (1 ECTS = 25 orë), ngarkesa javore në auditor dhe jashtë auditorit, sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh (60 ECTS) ose 1500 orë mësimore pune të studentit janë në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 dhe VKM nr. 41, datë 24.01.2018 <sup>16</sup> .  [Ref. 14.2 Plani mesimor i programit shqip]
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi studimit "Master Profesional në Menaxhim Biznesi" iu ofron studentëve njohuri të thelluara dhe të aplikuara në fushën e menaxhimit. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve të reja, zhvillimin e afësive dhe kompetencave të parashikuara në objektivat e programit. Ndarja e orëve në auditor dhe jashtë auditorit dhe veprimtaritë mësimore të parashikuara në secilën lëndë i jepin përparësi punës individuale të studentëve. GVJ duke iu refruar përmbajtjes së planit mesimor, emërtesës së lëndëve dhe syllabuseve të lëndëve konkludon që program studimit mundëson marrjen e njohurive të reja, i pajisë dhe aftëson studentët me njohuri për tëu futur në tregun e punës.  [Ref. 14.2 Plani mesimor i programit shqip, Ref. Syllabuset]
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Ngarkesa e programit të studimit është shpërndarë në mënyrë të barabartë në të dy semestrat. GVJ është i mendimit se shpërndarja e lëndëve dhe krediteve për çdo lëndë mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe arritjen rezultateve të pritshme të të nxënit. Shpërndarja e ngarkesës është e njëjtë mes semestrave duke i dhënë një ngarkesë të njëjtë studentëve. Shpërndarja e lëndëve, është e tillë që në semestrin e parë mundëson kryesisht marrjen e njohurive bazë dhe formuse, ndërsa në semestrin e dytë realizohet thellim dhe profilizim në disiplinat karakterizuese dhe ato me zgjedhje të programit. <b>GVJ rekomandon që ngarkesa për punimin e diplomës/provim i përgjithshëm formimi të kalojë në semestrin e dytë, mbështetur në arsyetimin e dhënë më sipër.</b>  [Ref. 14.2 Plani mesimor i programit shqip; Ref. 14.4. Plani mesimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - MP Menaxhim Biznesi]
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit përbëhet nga 7 lëndë, secila me nga 6 ECTS. 4 lëndë janë të detyrueshme, ndërsa 3 lëndët e tjera merren në varësi të profilit që zgjedh student. GVJ konstatoi që lëndët që merren sipas profilit mundësojnë specializimin e studentëve në këto profile. Duke iu referuar DVV dhe takimeve në institucion me drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore, rezultoi që shpërndarja lëndore, numri i lëndëve, kreditet e çdo

<sup>16</sup> Ligji Nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH, neni 75, pika 6 dhe VKM Nr. 41, data 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, pika 2.1.



	<p>lënde, janë të ngjajshme me programe të përafërta të universiteteve evropiane.</p> <p><i>[Ref. 14.2 Plani mesimor i programit shqip; Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përqindja e lëndëve sipas veprimtarive formuese është sipas përqindjeve të parashikura në VKM 41, datë 24.01.2018 (shtojca nr. 1). Format e zhvillimit të procesit mësimor janë të larmishme (leksione, seminare, detyra praktike, detyra kursi, provime të ndërmjetëme, provime përfundimtare) dhe krijojnë një balance midis formimit teorik dhe atij praktik. GVJ mbështetur në DVV, takimet me personelin akademik dhe studentët konstatoi që lëndët e përfshira në planin mësimor dhe format e zhvillimit të procesit mësimor mundësojnë arritjen e objektivave formuese. Ndarja sipas veprimtarive formuese mundëson gjithashtu transferimin e studimeve.</p> <p><i>[Ref. 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - MP Menaxhim Biznesi (Aneks_Tabela 9); Ref. 14.2 Plani mesimor i programit shqip; Ref. Syllabuset; Ref. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, fq.1]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>UET ka procedura të miratuara për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Referuar dokumentacionit në DVV dhe takimeve me personelin akademik, GVJ konstatoi se syllabuset përditësohen vazhdimisht, si detyrim ndaj kërkesave ligjore, por edhe për të përditësuar literaturën. UET përdor materiale mësimore në gjuhën shqipe, gjuhën angleze dhe tekste të përkthyer nga anglishtja kryesisht. Literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar rezulton e përditësuar, por kushti i 5 viteve të fundit për arsye objektive nuk mund të realizohet për çdo lëndë dhe çdo titull.</p> <p><i>[Ref. 19, Syllabuset; Ref. 37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve; Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit përmban disa lëndë të cilat mundësojnë marrjen e njohurive të thelluara në fushën e menaxhimit si: Menaxhimi i Operacioneve, Menaxhimi i Cilësisë dhe Menaxhimi financiar, duke bërë të mundur që përmbajtja e programit të garantojë përfitimin e dijeve të reja, aftësimin e studentëve për t'i përdorur këto njohuri në praktikë dhe për të arritur kompetencat e synuara për këtë program studimi. Grupi i lëndëve me zgjedhje garanton një specializim më të ngushtë dhe të përshtatshëm sipas profileve. GVJ konkludoi që plani mësimor përmban lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje që garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit.</p> <p><i>[Ref. 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip); Ref. 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të studimit MP Menaxhim Biznesi, pika II, fq.2]</i></p>



<p><b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Mbështetur në DVV dhe takimin e personelin akademik dhe studentët GVJ konstatoi që në format e kontrollit të dijeve diskutimi në seminare dhe detyrat e kursit zënë 30% të vlerësimit të vazhduar. Ndërsa në metodat e realizimit të seminareve përdoret diskutimi i rasteve studimore në disa lëndë si: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Menaxhimi Strategjik, Menaxhimi i Operacioneve, Vlerësimi i Politikave Publike, etj. që mundëson aftësimin e studentëve për të analizuar situata të veçanta në profilet e zgjedhura prej tyre. Praktika profesionale, që zhvillohet në institucione dhe sipërmarrje të ndryshme mundëson gjithashtu aftësimin dhe formimin e thelluar të studentëve në profilet e zgjedhura. GVJ mendon që organizimi i programit të studimit siguron formim, aftësim dhe kompetenca të thelluara profesionale.</p> <p><i>[Ref. 19 Syllabus; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>								
<p><b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Referuar DVV dhe vizitës në institucion GVJ konkludoi që programi i studimit iu mundëson studentëve daljen në tregun e punës në profile që janë të kërkuara. Programi i studimit mundëson gjithashtu transferimin e studimeve në programe të ciklit të dytë Master i Shkencave në fushën e Menaxhim Biznesit.</p> <p><i>[Ref. 29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve; Ref. 53. Ligji 802015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”, neni 89, pika 1, fq.30; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="596 1077 780 1160"></th> <th data-bbox="780 1077 999 1160">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="999 1077 1216 1160">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1216 1077 1434 1160">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="596 1160 780 1202"></td> <td data-bbox="780 1160 999 1202"></td> <td data-bbox="999 1160 1216 1202"></td> <td data-bbox="1216 1160 1434 1202">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar evidencës 25 (Te dhenat e tabelës 6)] stafi i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë katër viteve akademike është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022 janë të angazhuar 10 pedagogë ndër të cilët 9 PAE dhe 1 PAK. Mbulimi i ngarkesës së programit në përqindje është 92.9.0% PAE dhe 7.1% PAK.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar 11 pedagogë ndër të cilët 7 PAE dhe 4 PAK. Mbulimi i ngarkesës së programit në përqindje është 71.4% PAE dhe 28.6% PAK<sup>17</sup>.</p>

<sup>17</sup> Nuk përputhet tabela 6 me 12 për këtë vit



<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Për vitin akademik <b>2019-2020</b> janë të angazhuar <b>11</b> pedagogë ndër të cilët <b>9 PAE</b> dhe <b>2 PAK</b>. Mbulimi i ngarkesës së programit në përqindje është <b>82.3% PAE</b> dhe <b>18.7% PAK</b>.</p> <p>Për vitin akademik <b>2018-2019</b> janë të angazhuar 12 pedagogë ndër të cilët <b>9 PAE</b> dhe <b>3 PAK</b>. Mbulimi i ngarkesës së programit në përqindje është <b>82.3% PAE</b> dhe <b>18.7% PAK</b><sup>18</sup>.</p> <p>Për sa i përket kualifikimeve të PA:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për të gjithë periudhën nga akreditimi i mëparshëm në mësimdhënie është angazhuar kryesisht personel akademik me grada shkencore/tituj akademik;</li> <li>- GVJ konstatoi që çdo vit akademik është angazhuar një personel akademik që nuk ka patur kualifikimin e kërkuar<sup>19</sup>.</li> </ul> <p>Referuar dokumentacionit të konsultuar më sipër si dhe CV-ve të personelit akademik, GVJ konstatoi se për të katër vitet e fundit akademike, programi i studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përmbush kërkesën ligjore që personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi (VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, pika 2.b/ii).</li> <li>- përmbush kryesisht kërkesën ligjore të të pasurit së paku kualifikimin e një cikli pasardhës për personelin akademik që mbulon ngarkesëm e programit të studimit;</li> <li>- niveli i kualifikimit, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e lëndëve të tij.</li> </ul> <p>[Ref. 25. Ngarkesa e personelit akademik të programit (aneks tabela 6.7.8.12)]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Praktika profesionale është lëndë e detyrueshme e programit të studimit. Ajo organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës. Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion GVJ konstatoi që IAL ka një listë të institucioneve dhe subjekteve private me të cilat bashkëpunon për realizimin e praktikës. Për çdo student caktohen dy mbikëqyrës, një pedagog dhe një person në institucionin ku kryhet praktika. Departamenti i Manaxhimit dhe Marketingut angazhon gjithashtu personelin e duhur për instruktimin dhe udhëheqjen e studentëve për punimin e diplomës. Pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari të shpallur dhe orientojnë studentët mbi tematikën e punimit të diplomës, strukturën e punimit, metodologjinë, literaturën që duhet të përdorin dhe shmangien e plagjaturës.</p>

<sup>18</sup> Tabela 6 nuk përputhet me tabelën 1 për këtë vit

<sup>19</sup> Në vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar 2 personel akademik me Msc.



	[Ref. 32. Lista e Subjekteve dhe Institucioneve bashkepunuese per programin e studimit dhe praktikat profesionale; Ref. 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale; Ref. 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, pika 7, fq. 5; pika 8, fq. 5-6]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Kurrikula e programit të studimit nuk parashikon orë pune në laborator. Megjithatë gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se përveç personelit akademik, në ndihmë të procesit mësimor, institucioni angazhon edhe staf administrativ, të cilët përgjigjen për mirëmbajtjen e sallave të leksioneve dhe seminareve.  [Shënime gjatë vizitës në institucion]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi II.6

**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Për të tërhequr propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës, UET ka miratuar krijimin e Bordit të Tregut të Punës si një organ këshillues. Bordet ngrihen në nivel departamenti dhe konsultojnë programet e studimit dhe planet mësimore përpara fillimit të vitit akademik, për të garantuar përputhjen e tyre me kërkesat e tregut të punës. Sipas DVV bordi është funksional dhe në përbërje të tij ka ekspert të fushave që lidhen me programin e studimit. Në axhendën e takimeve është parashikuar diskutimi i përmirësimit të programeve mësimore dhe praktikave profesionale me nevojat e tregut të punës, të sipërmarrjeve dhe bashkëpunëtorëve të institucionit. Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoj që departamenti e ka përdorur këtë instrument, megjithatë nuk u identifikua ndonjë rast kur plani mësimor të ishte ndryshuar mbështetur në këto propozime.  [Ref. 2. Statuti i UET, neni 18, pik 18.1.a, fq. 7, pika 18.4, 18.4.1, 18.4.2, fq. 8; Ref. 12.1 Bordi i Tregut të Punës; Ref. 12.5. Axhenda e takimit me Bordin e Tregut të Punës]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Sipas DVV rezultojnë që UET ka procedurë të miratuara për përfshirjen e studentëve në qeverisjen e institucionit. Disa nga format e parashikuara në këtë procedurë janë përfshirja në procesin e hartimit, diskutimit, rishikimit dhe miratimit të planeve mësimore dhe programeve të studimit; vlerësimi i përmbajtjes dhe cilësisë së mësimdhënies përmes anketimeve dhe përfshirja në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Institucioni inkurajon studentët për tëu përfshirë në vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. IAL për të mundësuar përfshirjen



	<p>e tyre përdor formularin e vlerësimit të studentëve për pedagogun dhe lëndën. Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi që IAL i ka përdorur këto instrumenta. Gjetjet e pyetësorit i vihen në dispozicion Departamentit, i cili identifikon nevojat për përmirësime dhe reflekton propozimet në programin e studimit.</p> <p>[Ref. 58. D.III Mbi perfshirjen e studenteve në qeverisjen e UET, pika D.III.3; Ref. 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët]</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>UET ka përfshirë gjithashtu në konsultimet për përmirësimin e programeve të studimit dhe studentët e diplomuar, duke i bërë ata antarë në Bordin e Tregut të Punës apo struktura të tjera këshilluese. <b>GVJ nuk gjeti evidence mbi rezultatet që ka prodhuar ky proces.</b></p> <p>[Ref: 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, pika EVII6, fq.86]</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>UET ka procedura të miratuara që i mundësojnë përshtatjen dhe riorganizimin e programeve të studimit në fusha specifike studimi dhe kërkimi. Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, <b>GVJ nuk gjeti ndonjë evidencë që programi të jetë përshtatur apo riorganizuar sipas këtij kriteri.</b></p>								
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p><b>Standardi III.1</b>  <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar në Strategjinë e Kërkimit Shkencor në UET (2021-2025), UET synon të konsolidojë identitetin e universitetit si qendër e prodhimit të dijes në Shqipëri e të transformohet nga një institucion i arsimit të lartë i fokusuar në mësim-dhënie, në një institucion elitare kërkimor, produkti kërkimor i të cilit kërkohet nga tregu dhe përmirëson në vazhdimësi mësimdhënien dhe eksperiencën studentore në UET. Për të arritur këtë, kjo strategji detajon objektivat dhe instrumentat specifike për të strukturuar, përparuar, standardizuar dhe ndërkombëtarizuar kërkimin</p>



	<p>shkencor. Në një nga objektivat strategjike, thuhet që Institucioni duhet të perfeksionojë mësimdhënien dhe zhvillimin akademik në të gjitha nivelet, në mënyrë që studentët të përjetojnë një përvojë dhe një kulturë akademike sfiduese. GVJ vlerëson pozitivisht hartimin e udhëzuesit në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> <p><i>[Ref: 3.2. Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025, pika 3.3]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Institucioni përdor metoda të ndryshme për të matur cilësinë e mësimdhënies, për të monitoruar syllabuset, si dhe angazhimin e stafit në aktivitetet shkencore të cilat janë të rëndësishme në kombinimin e kërkimit shkencor dhe mësimdhënies.</p> <p>Përgjegjësi i njësisë bazë bashkë me përgjegjësat e grup-lëndëve janë struktura përgjegjëse për zhvillimin e monitorimit të mësimdhënies dhe adoptimin e saktë të syllabuseve përkates. Ata kryejnë monitorimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme gjatë orëve të leksionit dhe seminarit, duke plotësuar një formular vlerësimi të orës mësimore në vëzhgim, si dhe vlerësuar syllabuset për çdo lëndë e cila kryhet nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC).</p> <p>Si pjesë plotësuese e vlerësimit të mësimdhënies, lektorët vlerësohen dhe nga studentët, ku ato kanë të drejtë të shprehin aspektet pozitive ose negative të lëndës përkatëse përveç pyetjeve konkrete që ata duket ti përgjigjen.</p> <p><b>Për një vlerësim akoma më konkret në përfshirjen e metodave inovative, tëheqëse, dhe të përshtatshme për lëndët përkatëse, GVJ sugjeron përfshirjen të disa indikatorëve specifike në formularet e vlerësimit të stafit.</b></p> <p><i>[Ref: 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprorikolegu; Ref: 37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve; Ref: 40. G-III-4-2 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentet; Ref: 41. G-1-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Institucioni është i angazhuar dhe garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve.</p> <p>Gjithashtu institucioni përdor mekanizma efikase për të trajtuar ankimimet e studentëve nëpërmjet mbledhjeve mujore me vete studentët ku diskutohen problematikat që mund të kenë.</p> <p>Gjithashtu studentët në mënyrë anonime vlerësojnë lëndët përkatëse në fund të çdo semestri.</p> <p>Duke marrë parasysh të gjithë këto mekanizma vlerësimi, përgjegjësit e njësisë bazë kanë informacionin e mjaftueshëm për të nxjerrë</p>



	<p>konkluzione mbi cilësinë e punës se secilit, dhe për të dhënë disa sugjerime për përmirësim. Përsa i përket vlerësimit individual të studentëve, fillimisht kryhen seanca sqaruese brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të provimit, dhe në rast pakënaqësie në përfundim të këtyre seancave, studenti i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit për rivlerësim.</p> <p>GVJ konstaton që programi i studimit ka përdorur monitorime të ndyshme dhe të ndërthorta për patur një vlerësim periodik sa më të plotë.</p> <p><i>[Ref: 40. G-III-4-2 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentet; Ref: 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studenteve; Ref: 5. Rregullore UET, Neni 27, pika 27.9, fq.8; Neni 32, fq.9</i></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Vlerësime periodike kryhen nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) i cili është i angazhuar për të bërë kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarive mësimore e kërkimore dhe ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Veprimtarinë e saj KSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një Plan-Vepimi për cdo vit akademik. Gjetjet e kontrolleve paraqiten në raportet përkatëse dhe u bëhen të ditura drejtuesve të fakulteteve dhe stafit akademik duke u bërë publike.</p> <p>Kontroll tjetër shtesë është ai i provimeve të ndërmjetme dhe atyre përfundimtare, ku KSBC nxjerr përfundime dhe bën njoftimet përkatëse. Pra çdo aktivitet kontrolli shoqërohet me raport dhe njoftim tek personat përkatës. GVJ konstaton që IAL ka ngitur stuktura të përkatëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie duke bërë publike rezultatet e vlerësimit.</p> <p><i>[Ref: 2. Statuti UET, Kreu 1, Neni 11, pika 3, fq.5; Ref: 8. Dokumenti F.VII Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë]</i></p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni ka strukturat e nevojshme dhe procedurat e përshtatshme për të matur vijueshmërinë dhe cilësinë në mësimdhënie, duke përdorur forma të ndryshme monitorimi lidhur me vlerësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Të gjitha gjetjet dhe praktikat e mira diskutohen në nivel departamenti duke nxitur kështu dhe përmirësimin e mëtejshme të mësimdhënies. Mbështetur në DVV, GVJ konstatoi që IAL promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 1671 807 1749"></th> <th data-bbox="807 1671 1016 1749">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="1016 1671 1225 1749">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="1225 1671 1437 1749">Nuk përmbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="598 1749 807 1794"></td> <td data-bbox="807 1749 1016 1794"></td> <td data-bbox="1016 1749 1225 1794"></td> <td data-bbox="1225 1749 1437 1794">X</td> </tr> </tbody> </table>		Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet				X
	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet						
			X						

**Standardi III.2**

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Duke u bazuar në rregulloren UET dhe në syllabusët e lëndëve të programit të studimit, format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, esete/detyra e kursit, praktika profesionale, etj.</p> <p>Leksionet dhe seminarët zgjasin për 14 javë (semestri) dhe në javën e 13-të të semestrit studentet dorëzojnë detyrat e kursit/ esetë në lëndët e zhvilluara.</p> <p>Njëkohësisht, kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit. Gjithashtu, në bashkëpunim me tregun e punës, Departamenti vazhdimisht zhvillon leksione të hapura me ekspertë të fushës së menaxhimit.</p> <p>GVJ pasi pa me kujdes DVV konkludon përdorimin e metodve të përshtatshme dhe të larmishme që i përshtaten programit të studimit.</p> <p><i>[Ref: 5. Rregullore e UET, Neni 17, pika 1, fq.5; Ref: 19. Syllabusët e Lëndëve të ofruara për programin Master Profesional në Menaxhim Biznesi; Ref: 5. Rregullore e UET, Neni 26, pika 2, fq.8; Ref:17. Studimi (periodik) për tregun e punës]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Format, mënyrat dhe metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të specifikuar në syllabusin e secilës lëndë, të cilat ndërtohen në përgjigje të nevojave të lëndës dhe studenteve, dhe përmbajnë rubrika si: "Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës", "Literaturë bazë e detyrueshme", "Literaturë e rekomanduar", etj.</p> <p>Në zhvillimin e lëndëve në auditor përdoren gjerësisht edhe mjete ndihmëse si tabela, kompjuteri, projektori, etj. Metoda të tjera për t'iu përgjigjur diversitetit përfshijnë diskutime dhe punë në grupe me studentët, analiza e rasteve të studimit, organizimi i diskutimeve që nxisin mendimin kritik, etj.</p> <p>Duke u bazuar në vizitën pranë ambienteve të institucionit, si dhe në komunikimin që kishim me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se institucioni siguron përdorimin e mjeteve didaktike të nevojshme si tabela, kompjuteri, projektori, etj. Gjithashtu institucioni ka organizuar me sukses përdorimin e platformës MS Teams si dhe të platformës LMS, e cila përdoret për shpërndarjen e materialeve mësimore.</p> <p><i>[Ref: 19. Syllabusët e Lëndëve të ofruara për programin Master Profesional në Menaxhim Biznesi; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave</p>	<p>Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike duke trajnuar stafin e secilit prej departamenteve në çdo fillim viti akademik.</p> <p>Ky aktivitet realizohet gjatë programit një javor "Back to Work" ku</p>



<p>të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>drejtuesit e universitetit dhe profesorë me tituj akademike kryejnë trajnimin mbi ecurinë e aktivitetit akademik dhe menaxherial të IAL. Gjithashtu, në vitin akademik 2019-2020 është realizuar trajnimi "UET 2020: Mësimdhënia, cilësia, strukturimi" për pedagogët e Universitetit ku profesorë me tituj akademik trajnuan pedagogët mbi metodat e reja të mësimdhënies, inovacionit si dhe trajnim mbi përdorimin e platformës elektronike LMS. Një evidencë shtesë në mbështetjen e stafit me kompetenca didaktike është dhe trajnimi online, i organizuar në formë webinar organizuar nga Echnological Educational Institute of Crete. Aktiviteti konsistonte në prezantimin e metodave të reja të mësimdhënies dhe sjelljes së pedagogëve kundrejt studentëve. Trajnime të tjera specifike kanë qenë ato trajnime në përforcimin e njohurive në mësimdhënien online.</p> <p>Gjithashtu, personeli akademik i programit të studimit kanë përfituar nga programet e shkëmbimit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe për tëu njohur me praktikat më të mira ndërkombetare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. GVJ është e mendimit se IAL jo vetëm që mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, por dhe mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike që ndihmojnë në mësimdhënie.</p> <p><i>[Ref: 33. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin; [Ref: 46.2. UET LMS - Guidë për pedagogun; Ref: 43.1. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studenteve]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Duke u bazuar në CV e depozituara të stafit akademik, eksperiencat e tyre dhe nga komunikimi me ta, GVJ shpreh mendimin se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p> <p>Gjithashtu vlen për tu përmendur fakti se lëndët e programit janë në përputhshmëri me fushën e kërkimit dhe ekspertizën e stafit akademik. Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi përdorimin e metodave interaktive dhe diskutimet në mësimdhënie të cilat janë shembull i aftësive të personelit akademik në mbështetje të mësimdhënies në forma të larmishme për studentët.</p> <p><i>[Ref: 20. CV e stafit akademik të programit të studimit; Ref: 19. Syllabuset e Lëndëve të ofruara për programin Master Profesional në Menaxhim Biznesi; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët</p>	<p>Nga sa u tha dhe më sipër, drejtuesit e njësisë kryesore ju bëjnë me dije stafit të departamentit rezultatet e vlerësimeve të tërthorta, si ato të vlerësimit të syllabuseve, të vlerësimit gjatë në ore mësimore, vlerësimet nga studentët, si dhe vlerësimet me fokus grupe të përfshirë</p>





<p>në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>në vlerësim pedagogu/lënde. GVJ konstatoi përfshirjen e studentëve në vlerësimin e mësimdhënies; si dhe disa mënyra dhe sugjerime të studenteve që janë pjesë e rëndësishme në reflektime të mëtejshme të punës së pedagogut.</p> <p><i>[Ref: 30.1. Plani veprimit KSBC; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit]</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Syllabusi i çdo lënde përmban informacione të detajuara në lidhje me strukturën e vlerësimit dhe ecurinë e lëndës. Shumë nga lëndët e paraqitura në programin e studimit kanë përfshirë prezantime projektesh, punë në grup, si dhe mënyra aktivizime të tjera. Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi që stafi i programit aplikonte metoda interaktive për ta bërë sa më tërheqëse orën mësimore. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>[Ref: 19. Syllabuset e Lëndëve të ofruara për programin Master Profesional në Menaxhim Biznesi; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit]</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Duke u bazuar në Strategjinë e UET 2021-2025, dhe Statutin e UET, një nga objektivat e institucionit është të inkurajojë sensin e autonomisë së studenteve, dhe nxitjen e mendimit kritik të tyre, objektiva të cilat kryhen dhe nga stafi akademik.</p> <p>Hartimet e mënyrës së mësimdhënies të cilat përfshijnë dhe metoda të ndryshme interaktive mundësojnë organizimin dhe angazhimin e studentëve në grupe pune. Nëpërmjet punës në ekupe studentët e këtij programi studimi nuk aftësohen vetëm në diskutimin e koncepteve teorike të cilat do të ndihmojnë në formimin e kompetencave dhe aftësive profesionale sipas profileve përkatëse të përzgjedhur prej tyre, por aftësohen gjithashtu për inkurajimin e autonomisë duke punuar në mënyrë të pavarur. GVJ mendon se format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar një marrëdhënie respekti të ndërsjellë mes lektorit dhe studentëve.</p> <p><i>[Ref: 2. Statuti UET, Neni 6, fq.3; Ref: 3.2. Strategjia UET 2021-2025; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 6. Takimi me studentët e programit të studimit]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

**Standardi III.3**

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Në vitin e ri akademik, 2021-2022, Universiteti Europian i Tiranës është zhvendosur nga një sipërfaqe rreth 10,000 m<sup>2</sup>, në ambiente të reja me një sipërfaqe totale 7,545 m<sup>2</sup>. UET ka në dispozicion 3 godina ku zhvillohet procesi akademik dhe 4 godina me ambiente teknike shërbimi. Objekti është i pajisur me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit. Përveç sallave mësimore prej rreth 45 të tilla, labororet e arteve, palestrës dhe zyrave përkatëse, UET ka dhe Sallën Aula Magna me një sipërfaqe rreth 110 m<sup>2</sup>, e një kapacitet akomodues prej 70 vende. Ambienti është i pajisur me një post të konceptuar për regjinë dhe produksionin audio e video. Sallat për leksionet dhe seminarat janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në institucion konstatoi që IAL kishte ambiente ku përfshihej dhe biblioteka universitare, e cila u vlerësua si e pamjaftueshme për të përfshirë të gjithë librat e fondit të bibliotekës.</p> <p><i>[Ref: 42.1. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programit-rruga "Xhanfize Keko"]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>UET ka në përdorim 45 salla mësimore, (17 salla laboratore- 410 vende total, 13 salla për seminare- 353 vende dhe 15 salla leksioni - 1138 vende). Aktualisht UET disponon një sërë laboratorësh të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. UET gjithashtu ka investuar në sisteme teknologjike, si psh. Moodle, LMS, etj, të cilat e mbështetin studentin në procesin mësimor. Nëpërmjet këtyre sistemeve, studentët mund të marrin online të gjitha materialet mësimore, didaktike, si dhe të ndjekin vlerësimet e tyre gjatë procesit.</p> <p>Njëkohësisht, labororet e informatikës/statistikës janë pajisur me softwarët përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Më konkretisht, sistemet e operimit janë të gjithë Windows 10, MS TEAMS; Microsoft Office, etj. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht webin dhe sistemet online. GVJ konstatoi se ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p> <p><i>[Ref: Datë 10.05.2022, Takimi nr. 6. Vizitë në Laboratore, Salla mesimore, etj.]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Stafi i Zyrës së IT-së, i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës, dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, është i kualifikuar dhe në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimimit. Mirëmbajtja e pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit.</p>



	<p>Gjithashtu të gjitha instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre manaxhohen nga kjo zyrë. Në bazë të kërkesave specifike, stafi i zyrës së IT-së instalon programet kompjuterike në shërbim të procesit mësimor. UET-LMS dhe Teams janë dy sistemet më të përdorura në mësimdhënien online dhe atë tradicionale. Duke u bazuar në dokumentacionin përkates si dhe vizitës në institucion, GVJ konfirmoi që IAL ofron një infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p> <p><i>[Ref: 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS; Ref: 46.3. UET LMS Guidë për studentët; Ref: Datë 10.05.2022, Takimi nr. 6. Vizitë në Laboratore]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Referuar syllabuseve të çdo lënde, si dhe komunikimeve që GVJ kishte me stafin dhe studentët, u analizua literatura bazë për çdo modul që ofrohet në këtë program studimesh e cila ofrohej në gjuhën shqipe.</p> <p>Për ndërtimin e literaturës bazë, pedagogët e këtij programi studimi përdorin tekste të huaja, kryesisht të viteve të fundit, të cilët garantojnë marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në këtë program studimi. Përveç materialeve fizike, UET ofron dhe materiale elektronike nga burime të ndryshme, si: Sage &amp; EBSCO, Questia, ASTM Compass, Edward Elgar Publishing - Elgar Online Platform. Duke u bazuar në dokumentacionin përkates si dhe vizitës në institucion, GVJ konfirmoi që IAL ka literaturë të mjaftueshme fizike dhe elektronike për realizimin e procesin mësimor.</p> <p><i>[Ref: 19. Syllabuset e Lëndëve të ofruara për programin Master Profesional në Menaxhim Biznesi; Ref: Datë 10.05.2022, Takimi nr. 6. Vizitë në Bibliotekë]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Fondi i Bibliotekës për vitin akademik 2021-2022 është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Totali i librave Bruto, Periodik, CD &amp; Harta 7210 + 2739 total tituj</li> <li>• Sqarim: 7210 tituj janë regjistruar në katalogun tonë online dhe 2739 janë në proces për tëu regjistruar në katalogun tonë online.</li> <li>• Libra në gjuhën shqipe 4921 tituj.</li> <li>• Libra në gjuhë të huaj 4204 tituj.</li> <li>• Periodik total përafërsisht 210 tituj.</li> <li>• Periodik shqip përafërsisht 105 tituj.</li> <li>• Periodik në gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht) përafërsisht 105 tituj.</li> </ul> <p>Specifikisht për fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit ka gjithsej 19998 tituj. Sipas Ref. Nr. 45: Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit të studimit MP Menaxhim Biznesi, aty ka një listë prej 1278 librash që i përkasin këtij programi.</p> <p>Biblioteka gjithashtu ka akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencore si: Sage &amp; EBSCO, Questia, ASTM Compass, Edward Elgar Publishing - Elgar Online Platform.</p>



	<p><b>Megjithatë, siç u vu re dhe nga vizita e GVJ pranë ambienteve të bibliotekës, Universiteti mundëson aksesin e një larmishmërie librash, por numri i posteve të punës ishte i kufizuar dhe nuk mundëson shfrytëzimin e librit në bibliotekë. Studentët përdorin më shumë metodën e huazimit të librave për një periudhë kohore sesa shfrytëzimin e tyre pranë ambienteve të bibliotekës.</b></p> <p><i>[Ref: 45. Inventari i teksteve në Bibilotekë për fushën e programit të studimit MP në Menaxhim Biznesi]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit, konkretisht janë kryer abonime në biblioteka virtuale si: Sage, Ebsco dhe revista shkencore në hard copy, të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik mijëra tituj librash dhe artikuj shkencore bashkëkohore.</p> <p><b>Megjithëse kjo mundësi ekziston, GVJ nuk konstatoi statistika në lidhje me përdorshmërinë e këtyre burimeve nga ana e studentëve.</b></p> <p><i>[Ref: Datë 10.05.2022, Takimi nr. 6. Vizitë në Bibliotekë]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>UET ka siguruar infrastrukturën e nevojshme laboratorike pasi ka vënë në dispozicion të studentëve 16 laboratore mësimore &amp; informatike të cilët janë të pajisur me PC, video projektor dhe mjete audio vizive. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softwarët përkatës në mënyrë që t’i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. GVJ konstatoi se të gjithë laboratorët janë të pajisur me të gjitha mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme që studentët të kenë akses në aktivitetet e tyre akademike.</p> <p><i>[Ref: 42.1. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programit- rruga "Xhanfize Keko"; Ref: Datë 10.05.2022, Takimi nr. 6. Vizitë në Laborator]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Për mësimdhënien online UET ka aplikuar platformën Microsoft Teams e cila ka ardhur si nevojë imediate gjatë kohës së pandemisë. Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 UET ka vënë në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për menaxhimin e mësimdhënies online. LMS është një aplikacion web për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen e materialeve mësimore dhe informacionit tjetër të rëndësishëm për studentët. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në institucion konstatoi që nga viti 2020 personeli akademik dhe studentët vazhdimisht komunikojnë në platformat online.</p> <p><i>[Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 6. Takimi me studentët e programit të studimit; Ref: 5.1. Vendim Mbi zhvillimin e</i></p>




	<i>procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe Mbi lëshimin e formave të diplomave]</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Sistemi i komunikimit të brendshëm realizohet si nëpërmjet adresave të Email-it të krijuara nga institucioni për stafin akademik, administrativ dhe studentët gjithashtu edhe nëpërmjet përmes platformave UMIS, LMS, TEAMS. Funkzioni kryesor i këtyre sistemeve është të lehtësojë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (njoftimet detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, etj.) mes pedagogut dhe studentëve, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësimnxënies, pasi studenti merr përmes sistemit, gjithë bazën didaktike dhe orientimet e pedagogut për lëndën, si edhe ka mundësi bashkëbisedimi në mënyrë virtuale. GVJ mbështetur në vizitën në institucion konstatoi që personeli akademik dhe studentët kanë komunikim të brendshëm elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.  <i>[Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 6. Takimi me studentët e programit të studimit]</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Studentët pajisen nga Departamenti përkatës me formularin e aplikimit për temën e diplomës, shoqëruar me listën e pedagogëve të mundshëm udhëheqës dhe me fushat e ekspertizës dhe/ose temat e propozuara. Udhëheqësi i punimit krahas takimeve të personalizuar zhvillon edhe seanca metodologjike në auditor me grupin e studentëve që udhëheq. GVJ është e mendimit se PS përdor mënyrat e duhura për të orientuar studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.  <i>[Ref: 10. Dokumenti 8.11. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	KSBC është njësi kryesore që koordinon dhe bashkërendit me njësitë kryesore bazë në kuadër të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie. Sipas rregulloreve përkatëse, KSBC përfshin rritjen e vazhdueshme të cilësisë së drejtimit të UET-it, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore, si edhe angazhimit të të gjitha niveleve drejtuese dhe organizative; aplikimin e vazhdueshëm të filozofisë së UET-it, duke zbatuar nje program

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

40  




	<p>akademik që përkon si nga ana konceptuale dhe kronologjikiht me synimet që ka UET-i; rritjen e vazhdueshme të cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur të qenin proaktiv dhe kritik në dhënien e opinionëve mbi çështje aktuale.</p> <p>Nga vëzhgimet e GVJ-së, KSBC ishte një nga zyrat më aktive e cila asistonte në procese të ndryshme për sigurimin e cilësisë.</p> <p><i>[Ref: 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë, pika 6.1 dhe 7.2; Ref: 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; Ref: 30.1. Plani i veprimit të KSBC]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia bazë, pra departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron. Specifikisht, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në bashkëpunim me njësinë bazë, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, janë përgjegjëse për garantimin e cilësisë së programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi. Ai përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si dhe shpërndan ngarkesën mësimore në përputhje me parimet dhe kriteret e vendosura, për të garantuar që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm. Gjithashtu, përgjegjësi i departamentit, bashkë me përgjegjësit e Grupit mësimor miraton syllabuset e hartuara, bën vlerësimin e mësimdhënies, duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimit nga personeli akademik, si dhe duke inkurajuar studentët të raportojnë për problemet që mund të kenë evidentuar, në mbledhjet e hapura me ta.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion e vënë në dispozicion konstatoi që IAL nëpërmjet KSBC-s asiston në vlerësimin e vazhdueshëm të programeve dhe të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së mekanizmave zyrtare për miratimin, vlerësimin periodik dhe për monitorimin e programeve dhe diplomave.</p> <p><i>[Ref: 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>UET është i përkushtuar të punësojë staf akademik me eksperiencë kombëtare dhe ndërkombëtare duke pasuruar kështu programet me metoda të reja mësimore dhe të nxënit aktiv. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse inkurajojnë promovimin e metodave inovative dhe aktive, si dhe kreative të mësimdhënies dhe të nxënit, të orientuara drejt studentëve (Ref. Nr. 4).</p> <p>Një aspekt tjetër që mbështet mësimdhënien novatore janë shkëmbimet dhe lëvizshmëria e studentëve dhe stafit.</p>



	<p>Studentët fitojnë njohuri si në klasë ashtu edhe jashtë saj: fitojnë njohuri përmes teksteve të lëndëve, leksioneve, diskutimeve në grupe të vogla, prezantimeve individuale dhe grupore dhe përmes projekteve kërkimore, leksioneve publike, ndërveprimet me ekspertët/praktikantët që vizitojnë kampusin, dhe veprimtari të bazuara në detyra kursi. GVJ konstatoi mbështetjen nga strukturat dhe njësitë përgjegjëse të eksperimentimit dhe zhvillimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>[Ref: 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të studimit MP Menaxhim Biznesi]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në bazë të statutit të UET, Kreu IV, neni 36, UET organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor në mënyrë periodike. UET u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Dy objektiva kryesore, të cilat UET i përmbush me sukses, janë trajnimet e stafit për mësimdhënie dhe kërkim shkencor me qëllim kualifikimin dhe avancimin e qasjes së tij përkundrejt mësimdhënies, apo kërkimit shkencor në nivele më të avancuara.</p> <p>GVJ shqyrtoi me kujdes listën e publikimeve, të trajnimeve, dhe të përfshirjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe është e mendimit se IAL ka ndërmarrë hapa konkrete në mbështetje të stafit akademik në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p><i>[Ref: 2. Statutit i UET, Kreu IV, neni 36; Ref: 33. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët e diplomuar; Ref: 43. Të dhëna mbi kërkimin shkencor 2017-2021_DMM; Ref: 43. Të dhëna mbi kërkimin shkencor 2017-2021_DMM]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si dhe njësia e mbulimit të programit të studimit, realizon leksione të hapura me pjesëmarrje të pedagogëve të huaj apo specialistë të mirënjohur të fushës së biznesit të cilat shërbejnë për marrjen e përvojës metodologjike dhe pedagogjike nga stafi i përfshirë në mësimdhënie.</p> <p>UET nxit përfshirjen e pedagogëve në mobilitete akademike dhe krijon mundësinë për implementimin e metodave të reja të mësimdhënies nëpërmjet shkëmbimesh eksperiencash nga pedagogë të universiteteve partnere jashtë vendit. Gjatë pesë viteve të fundit numërohen rreth 17 lektorë të huaj që kanë sjellë ekspertizën dhe përvojën e tyre në UET, si dhe 21 lektorë nga UET që ka qenë pjesë e mobiliteteve në universitetet partnere. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia bazë ka trajnuar vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p> <p><i>[Ref: 55.3. Aktivitetet e Departamentit të Menaxhim dhe Marketing]</i></p>



	2018-2022; Ref: 43.1 Të dhëna në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve]		
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Bazuar në kriterin përkatës, dhe në UET personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve. Kjo kategori personeli janë vazhdimisht të angazhuar në trajnime dhe projekte të ndryshme ku dhe kanë mundësi të përfitojnë sa më shumë ekspertiza që shërbejnë për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Gjithashtu dekani dhe përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me sekretarinë mësimore monitorojnë zhvillimin dhe ecurinë e procesit mësimor. GVJ është e mendimit se PS ka struktura përkatëse të cilat ndihmojnë në vlerësimin e performancës së çdo stafi të cilat shërbejnë në evidentimin e problematikave ose pikave të forta të stafit akademik dhe ndihmës. [Ref: 41. G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik]		
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Mobilitetet dhe përfshirja e stafit akademik në projekte të ndryshme shërbejnë si përvoja të reja në trajtimin e metodave të reja në mësimdhënie. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në institucion konstatoi që IAL teston metoda të reja në rastet kur stafi akademik pasuron metodat e mësimdhënies si rezultat i eksperiencave nga shkëmbimet dhe mobilitet Erasmus në universitetet partnere me të cilat institucioni bashkëpunon.  [Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit]		
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Angazhimi i lektorëve të ftuar, të cilët janë profesionistë të fushës, vlerësohet si element shumë i rëndësishëm për pasurimin e procesit të mësimdhënies dhe lidhjen me tregun e punës. GVJ mbështetur në dokumentacion konstatoi që në kuadër të ndërkombëtarizimit shumë lektorë të huaj të institucioneve partnere kanë vizituar institucionin, dhe janë angazhuar në mësimdhënie dhe leksione të hapura duke kontribuar kështu në mësimnxënien.  [Ref: 43.1 Të dhëna në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve]		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të	Në fillim të çdo semestri, studentët njihen me syllabusin e çdo lënde, ku përcaktohen qartë kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive. Vlerësimi i notës është i shpërndarë në disa kategori, si psh: provim i ndërmjetëm,

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

43



<p>posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>detyra kursi, projekte, diskutime, provimi përfundimtar, etj. Gjithashtu çdo lektor përfshin syllabusin e lëndës përkatëse në sistemin online LMS, ku secili student mund ta aksesojë në çdo kohë. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që studentët njoftoheshin për kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale.</p> <p>[Ref: 5. Rregullore e UET, Neni 23; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 6. Takimi me studentët e programit të studimit]</p>						
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Ashtu siç u tha dhe mësipër, studentët mund të aksesojnë në çdo kohë dhe lehtësisht syllabuset e çdo lënde në sistemin LMS. Në çdo fillim semestri atyre u vihet në dispozicion në forma të ndryshme programi dhe syllabuset e lëndëve që ofrohen. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që nëpërmjet syllabuseve ata informohen lidhur me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive që lidhet me tipologjinë e secilës lëndë.</p> <p>[Ref: 19. Syllabuset e Lëndëve të ofruara për programin Master Profesional ne Menaxhim Biznesi; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 6. Takimi me studentët e programit të studimit]</p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ është e mendimit se PS përmbush plotësisht kriterin pasi testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, si: Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive; Plotësimi i detyrimeve (projekte, detyrave të kursit, ese, etj.); Testimet gjatë vitit, dhe Provimi përfundimtar. Për kryerjen e vlerësimit, përdoren metoda të ndryshme: Teste të standardizuara, Dëgjime ne auditor, Vlerësimi me pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktike; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët, Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktik.</p> <p>[Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip; Ref: 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve]</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="592 1599 793 1675">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="793 1599 1005 1675">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1005 1599 1217 1675">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="592 1675 793 1722"></td> <td data-bbox="793 1675 1005 1722"></td> <td data-bbox="1005 1675 1217 1722" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			<b>X</b>
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		<b>X</b>					

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë</p>	<p>Studentët vlerësohen sipas disa kriterëve gjatë gjithë semestrit. Në përgjithësi, ekzistojnë dy korniza kohore të dedikuara për provimet e</p>



<p>vitet akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>ndërmjetme dhe provimet përfundimtare. Studentëve u kërkohet të punojnë në raste studimore, të bëjnë projekte ose të bëjnë një prezantim sipas çdo lënde detyrat përkatëse siç përcaktohet në syllabusin e çdo lënde të ofruar në kurrikulën e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion dhe në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konfirmoi që IAL ka përdorur një sërë kriteresh të shtrira përgjatë gjithë semestrit të cilat reflektohen dhe në vlerësimin final.</p> <p><i>[Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 6. Takimi me studentët e programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Duke nisur që nga viti akademik 2016-2017, UET ka filluar përdorimin e vlerësimit në mënyrë elektronike (nëpërmjet Clean Score) i provimeve /testimeve, si një nga format bashkëkohore të kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studentëve. Sipas GVJ, IAL ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, për të shmangur format e ndryshme të abuzimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Praktikë Profesionale, si një nga lëndët që lidhet dhe me njohuritë të përgjithshme, vlerësohet nga një komision me tre anëtarë, ku njëri prej tyre është përgjegjësi i praktikës për departamentin. Studentët vlerësohen në bazë të dosjes së praktikës dhe mbrojtjes së praktikës para komisionit. GVJ mbështetur në dokumentacion konstatoi që vlerësimi i praktikës është kusht për përmbyshjen e detyrimeve lidhur me kreditet e programit dhe me diplomimin.</p> <p><i>[Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, pika 5.8]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në UET provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Sekretimi i tezave përmes sistemit elektronik të barkodeve, ofron sekretim të identitetit të studentit dhe paanshmëri të vlerësimit. Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në IAL, GVJ konstatoi se prej rreth 2 vitesh, për shkak të pandemisë, pjesa më e madhe e provimeve janë zhvilluar online, dhe realizimi i të gjitha rubrikave të vlerësimit të provimit është bërë nëpërmjet platformës UET LMS dhe TEAMS.</p> <p><i>[Ref: 7. Rregullorja e programit të studimit Master Profesional Menaxhim Biznesi, pika 5.3; Ref: 9. Dokumenti mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore, pika 1.8.6; Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 6. Takimi me studentët e programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale</p>	<p>GVJ konstatoi se IAL siguron vlerësimin e njohurive dhe dijeve në</p>



<p>shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>provim, i cili shoqërohet me komente. Çdo provim përmban seksionin e vlerësimit të pedagogut për të argumentuar vlerësimin e tij. Gjithashtu stafi akademik zhvillon seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar çdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Pas kësaj seance pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet e studentëve, i cili depozitohet në departament dhe sekretarinë mësimore.</p> <p><i>[Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 6. Takimi me studentët e programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Gjatë zhvillimit të provimeve njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, ku kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. Gjatë provimeve angazhohen disa pedagogë për monitorimin e tyre. Krahas rregulloreve përkatëse të universitetit, UET përdor dhe softuerin Turnitin si një mekanizëm që kontrollon plagjiaturën për të gjitha detyrat me shkrim, nga punimet javore deri te punimet e diplomës. Secili prej anëtarëve të stafit akademik ka llogarinë e tij në platformën Turnitin, nëpërmjet të cilës ata mund të kontrollojnë për plagjiaturë të gjitha punimet, detyrat, tezat sipas nevojës. GVJ është e mendimit se PS përdor mekanizamt e duhura për të shmangur plagjiaturën dhe kopjimin.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Mbështetur në DVV, GVJ konstatoi që çdo dorëzim detyre, provimi, ose mënyre tjetër vlerësimi është parashikuar me data përkatëse në fillim të semestrit dhe reflekton në data specifike në syllabus dhe kalendar akademik. Stafi akademik dorëzon rezultatet e vlerësimit të seminarëve dhe detyrave të kursit, gjatë javës së 14-të (të fundit) të semestrit, duke ju përmbajtur afatit përkatës. Studentët njihen me rezultatet para datës së zhvillimit të provimit përfundimtar.</p> <p><i>[Ref: 5. Rregullore e UET, Neni 27 dhe Neni 28]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për tëu njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët njihen me vlerësimin si dhe për të rishikuar dhe konsultuar mbi vlerësimin e çdo detyre ose provimi. Seanca sqaruese e vlerësimit në përputhje me rregulloret ju vjen në ndihmë studentëve duke siguruar feedback mbi procesin e të nxëniet dhe procedurat e vlerësimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Studentët kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për rishikimin e vlerësimit të provimit, në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Në rast se komisioni i posaçëm i ngitur për shqyrtimin e ankimit të notës konstaton një vlerësim ndryshe, nota e re reflektohet menjëherë. Kjo u konstatua dhe nga bashkëbisedimet që GVJ kishte me stafin dhe studentët e këtij programi.</p> <p><i>[Ref: 5. Rregullore e UET]</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga</p>	<p>Në raste të veçanta kërkesë ankimi të provimit, ngrihet një komision i posaçëm për rivlerësimin e provimit, me tre anëtarë, në përbërjen e të</p>



komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	<p>cilit nuk është pedagogu i lëndës. Komisioni vendos nëse vlerësimi ka qenë korrekt ose jo, dhe ndërmerr veprimet e nevojshme sipas rastit, duke dhënë rezultatin përfund imtar. Detajet gjenden në rregulloren e këtij programi. GVJ konstatoi që PS ndiqte një procedurë efikase të dokumentuar dhe arkivuar.</p> <p><i>[Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip]</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi III.7</b> <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion përkatës konstatoi që ky program është hartuar duke mbajtur në konsideratë zhvillimet bashkëkohore në fushën e menaxhim biznesit, aftësimin e studenteve me njohuri aplikative dhe praktike, në funksion të përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të tregut të punës, në nivel kombëtar dhe rajonal. Ai synon ta pajisë studentin me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit;</li> <li>(b) Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale;</li> <li>(c) Formim qytetar të përgjithshëm;</li> <li>(d) Aftësi bazë për pune kërkimore;</li> <li>(e) Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative;</li> <li>(f) Aftësim për promovim personal.</li> </ul> <p><i>[Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion përkatës konstatoi që programi Master Profesional Menaxhim Biznesi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional Menaxhim Biznesi përfishin dhe mundësinë për studentet e huaj në mobilitete të marrin lëndë në gjuhën Angleze. Gjitashtu, si pikë strategjike derin në 2025, UET synon të ofrojë rreth 25% të lëndëve të çdo program në gjuhën Angleze.</p> <p><i>[Ref: 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip)]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde,</p>	<p>Në përmbajtje të formatit të miratuar të syllabusit të secilës prej lëndëve të programit të studimit në seksionin "Përmbledhje dhe qëllimet e kursit" sqarohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti.</p>



<p>analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Vlerësimi dhe analizimi i kompetencave dhe aftësive të fituara bëhet në sajë të statistikave të rezultateve përfundimtare të lëndës (të cilat përfshijnë të katër format e vlerësimit të cituara në kriteret e mësipërme) të cilat evidentohen nga pedagogu përkatës i lëndës dhe diskutohen në mbledhje të departamentit për reflektime të mundshme lidhur me qëllimet e programit të studimit. GVJ pasi pa me kujdes DVV dhe të gjitha programet e lëndore (syllabuset) konkludoi që PS analizon kompetencat dhe aftësitë që fiton student.</p> <p><i>[Ref: 19. Syllabuset e Lëndëve të ofruara për programin Master Profesional në Menaxhim Biznesi]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Seanca e fundit e seminarit trajtohet në formën e një seance konsultuese që orienton studentët për testin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, çështjet më të rëndësishme, struktura e përgjithshme e tezës sipas seksioneve dhe udhëzime të tjera lidhur me trajtimin e pyetjeve të provimit. Për paqartësi të tjera përsëri studentët kanë akses në komunikim të vazhdueshëm me lektorin drejtues. Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi që stafi akademik orienton studentët për testimet gjatë dhe në fund të semestrit.</p> <p><i>[Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 6. Takimi me studentët e programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i departamentit është i angazhuar në vazhdimësi në veprimtari shkencore jashtë programit të studimit. Lektorët e lëndëve programojnë zhvillimin e orëve të hapura dhe seminarëve me të ftuar të ndryshëm nga bota e biznesit si dhe diskutimin e çështjeve lidhur me zhvillimet më të fundit në fushën e studimit. GVJ është e mendimit se ky kriter është një nga pikat e forta në nivel institucioni dhe programi studimi.</p> <p><i>[Ref: 55.2. Kalendari i aktiviteteve të Departamentit Menaxhim dhe Marketing 2018 -2022]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që tëu japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Lëndët zakonisht mbahen në klasa, auditore dhe të gjithë pedagogët përdorin teknologjinë gjatë mësimdhënies. Megjithatë, në kohë trajnimesh, projektesh ose stimulimesh specifike, pedagogët mund të përdorin laboratorë dhe fusha të tjera mësimore. Njohuritë e marra në laboratore dhe praktikat profesionale ju japin mundësi studentëve të marrin njohuri të thella tekniko-praktike të nivelit profesional dhe praktik, që kërkohen në fushën e menaxhimit të biznesit. Si pjesë e raportit final i praktikës profesionale, studentëve iu kërkohet të sjellin një material të shkruar si reflektim i përgjithshëm mbi kompetencat e fituara dhe ndikimin që ka patur programi i studimit në procesin e punës, qasjen ndaj zgjidhjeve të problemeve dhe njohjen e tyre me tregun e punës. Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi që PS mësimdhënia realizohet në ambiente përkatëse sipas nevojave të lëndës.</p>



	<p>[Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 6. Takimi me studentët e programit të studimit]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ pasi pa me kujdes DVV dhe të gjitha programet e lëndore (syllabuset) konkludoi që lëndët janë hartuar në mënyrë të tillë që të kontribuojë në rezultatet e programit të studimit. Diskutimi dhe puna në grup shërbejnë si metoda interaktive të mësimdhënies dhe i mësimnxenies, duke ndihmuar studentët në zhvillimin e aftësive analitike konceptuale dhe inovative për zgjidhjen e rasteve të ndryshme të studimit si problematika të mundshme të bizneseve.</p> <p>Është e rëndësishme të theksohet se një fokus i veçantë i kushtohet të mësuarit, shkrimit, kërkimit dhe aftësive të prezantimit të studentëve si aftësi të nevojshme për pozicionet përkatëse të punës.</p> <p>[Ref: 5. Rregullore UET, Neni 26; Ref: 7. Rregullore e programit të studimit Master Profesional Menaxhim Biznesi, pika 5.7.2]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Nëpërmjet udhëzimeve dhe përcaktimit të temave apo rasteve studimore që përcakton pedagogu i lëndës lidhur me përmbushjen e detyrimeve të kursit, iu krijon studentëve klimën e përshtatshme për zhvillimin e ideve të tyre inovative. Si në rastin e temave specifike apo edhe të rasteve studimore studenti ka mundësinë të aplikojë teorinë dhe konceptet teorike me shembuj dhe raste konkrete të kompanive duke fituar aftësi analitike praktike dhe duke krijuar ide inovative. Gjatë bisedimeve me grupin e studentëve, GVJ konstatoi përfshirjen e studentëve në disa konkurse të organizuara nga institucioni ose partnerë të tij, ku ata kishin mundësi të shpalosnin idetë e tyre inovative, dhe thellimin shkencor.</p> <p>Gjithashtu stafi inkurajon studentet për kërkim shkencor bazuar dhe tek "Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025", ku një nga objektivat e të cilit është realizimi i një mjedisi stimulues të kërkimit shkencor për stafin akademik dhe studentët. GVJ vlerëson pozitivisht këtë kriter.</p> <p>[Ref: 3.2. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025]</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Pjesë e strategjisë kërkimore shkencore të UET është përfshirja e studentëve në konferenca dhe publikime shkencore me qëllim zhvillimin e ideve inovative dhe studime të avancuara për fusha specifike. Studentët janë përfshirë në konferencën shkencore ndërkombëtare që zhvillon UET, Ditët e Studimeve Shqiptare, dhe një listë të gjatë aktiviteteve të tjera.</p> <p>Shumë nga këto aktivitete kanë qenë falas për studentët e UET, ose kanë mundur mbështjen financiare për të përzgjedhurit në këto evente. Gjatë takimit me studentët GVJ u informua për përfshirjen në aktivitete shkencore të studentëve të këtij programi dhe mundësitë dhe që institucioni ju ofronte.</p> <p>[Ref: 55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH); Ref: Datë 09.05.2022,</p>



	<i>Takimi nr. 6. Takimi me studentët e programit të studimit]</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Eksperienca që personeli akademik merr gjatë mobiliteteve në institucionet/universitete partnere reflektohet në përmirësimin e formave të mësimdhënies dhe nxit studentët për mobilitete tek partnerët. Gjatë shkëmbimit të eksperiencave promovohen universitetet dhe vendet për të rritur shanset dhe motivimin e studentëve për një eksperience jashtë vendit. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në institucion konstatoi që personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.			
	<i>[Ref: 43.1. Të dhëna në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve; Takimi nr. 5. Takimi me stafin akademik të programit të studimit]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitim të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Gjithashtu, infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Labororet e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Mbështetur në DVV, GVJ konstatoi që programi i studimit garanton mundësitë e nevojshme për realizimin e praktikës profesionale pranë institucioneve pritëse duke u mbështetur dhe në sugjerimet e Bordit të Tregut të Punës.  <i>[Ref: 12.1. Bordi i Tregut të Punës; Ref: 32. Lista e Subjekteve dhe Institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale; Ref: Aneks Tabela 5; Ref: 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit _Blv. Gjergj Fishta; Ref; 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit _Rr. Xhanfize Keko]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitim sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Studenteve u mundësohet kryerja e stazhit në institucione të ndryshme me të cilat UET ka marreveshje bashkëpunimi. Në këto institucione ata njihen me format dhe teknologjitë egzistuese që lidhen me fushën në të cilën ata po studiojnë. Gjithashtu, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit mbështet studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve duke ofruar konsulencë për aplikime dhe shpërndarë informacion për mundësitë e punësimit, apo mundësitë për vazhdimin e specializimeve brenda ose jashtë vendit me qëllim përfitim sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. Referuar




	dokumentacionit të dorëzuar, GVJ është e mendimit se në bashkëpunim dhe partneritet, IAL garanton realizimin e praktikave profesionale dhe stazheve me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.			
	<i>[Ref: 32. Lista e Subjekteve dhe Institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale; Ref: 34. Marrëveshjet e bashkëpunimit UET; Ref: 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit]</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nga 60 kredite, Praktika Profesionale për programet Master Profesional në Menaxhim Biznesi përbëhet nga 6 kredite (ekuivalent me 150 orë pune për studentin). Studenti dorëzon dosjen e praktikës të përbërë nga dokumenta të posaçmë shoqëruar me vlerësimin nga pedagogu përgjegjës. Në përfundim të zhvillimit të praktikave profesionale, pedagogu që e mbikëqyr studentin gjatë praktikës ka për detyrë të dorëzojë pranë Koordinatorës së Departamentit formularin e vlerësimit të studentit, formularin e vlerësimit të studentit nga mbikëqyrësi në institucion/organizatë/kompani, formularin e vetëvlerësimit të plotësuar nga studentit dhe raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studentit sipas formatit përkatës. Vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet përpara një komisioni. GVJ mbështetur në dokumentacion e dorëzuar, konstaton ekuivalentimin e krediteve të përfutuara nga praktikave profesionale.  <i>[Ref: 14. Kurrikula e programit MP Menaxhim Biznesi (shqip); Ref: 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale; Ref: 32.2. B-I-4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës (nga Studenti)]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Standardi III.9</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Referuar Rregullores së programit të studimit Master Profesional Menaxhim Biznesi, institucioni harton procedure të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike, që në fillim të semestrit. Një nga kushtet për tu diplomuar studentit duhet të nënshtrohet një Provimi të Përgjithshëm Përfundimtar, ose të mbrojë një punim diplome, i cili mund të jetë praktik, aplikativ, studim rasti, punë praktike, produkt profesional dhe që lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programi i studimit. GVJ konstatoi që të gjitha detajet në lidhje



	<p>me procedurën e posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve gjenden në dokumentin “Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit”. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>[Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, Neni 8; Ref: 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Për studentët që plotësojnë kriteret për zhvillimin e temës së diplomës, punimi është i pavarur dhe krijues dhe synon të vërtetojë fitimin e aftësive dhe të kompetencave profesionale ose të njohurive të parashikuara. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, personeli akademik asiston studentët nëpërmjet seancave metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur, duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme. Detajet gjenden në dokumentin “Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit”. Njëkohësisht, sipas Rregullores së UET, tema duhet të jetë me karakter aplikativ/praktik në rastin e programeve me karakter profesional dhe programeve Master Profesional. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi se PS ka vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p><i>[Ref: 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit; Ref: 5. Rregullore e UET, Neni 39.]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit siguron që komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final të bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë një viti akademik, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Për studentët që zhvillojnë provimin e përgjithshëm përfundimtar, ky provim është konceptuar si një rast studimor kompleks, i lidhur ngushtë me profilin studimor të studentit, duke marrë parasysh që ky program ka katër profile. Në këtë provim, studentët duhet të aplikojnë njohuritë kryesore të përfuara gjatë vitit të studimit.</p> <p><i>[Ref: 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Bazuar në Dokumentin B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit, departamenti ndërmerr hapat e mëposhtëm në lidhje me ndjekjen dhe mbështetjen e tezave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti gjatë shqyrtimit të propozimeve të studentëve për temën e diplomës garanton që udhëheqësi i propozuar nga studentët të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe temën e propozuar.</li> <li>- Nëse nuk konstatohet përputhshmëri, atëherë Departamenti cakton një pedagog udhëheqës qv i përmbush këto kriterë.</li> <li>- Studentët njoftohen për listën e miratuar me temat dhe pedagogët udhëheqës.</li> </ul>





	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nëse nuk ka pedagogë të brendshëm të përshtatshëm për të udhëhequr një temë të caktuar, atëherë departamenti ka të drejtë të caktojë një pedagog të jashtëm brenda kritereve të kërkuara.</li> <li>- Gjatë seancave metodologjike ofrohet asistencë për përcaktimin e temave të diplomës dhe udhëzime të tjera mbi përmbajtjen e saj.</li> </ul> <p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton një organizim dhe mbështetje efikase të studentëve në përgatitjen e provimit final dhe diplomave.</p> <p><i>[Ref: 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Pedagogu i tezës bashkëpunon me studentin për rreth disa seanca metodologjike, ku diskutohen aspektet metodologjike, perpunimi i të dhënave me metoda sasiore dhe cilësore; punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/te dhënave, etj. Përveç këtyre takimeve, bashkëpunimi ndërmjet studentëve dhe pedagogut udhëheqës zgjat deri në përfundim të dorëzimit të diplomës. Kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës përcaktohen me rregullore të vecantë. Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se stafi i këtij program ishte mjaft i dedikuar në mbështetjen e kërkimit shkencor të studentëve.</p> <p><i>[Ref: 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me stafin e programit të studimit Mastër Profesional]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për tëu paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i diplomës ndjek çdo hap të procesit të përgatitjes së punimit të diplomës dhe ndihmon studentin në përpunimin e të dhënave dhe nxjerrjen e rezultateve. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike. Studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit. Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ është e mendimit se duke patur një numër të limituar studentësh që ndjekin temën e diplomës, asistimi në nxjerrjen e rezultateve si dhe sigurimi i cilësisë së punimit është më i lehtë.</p> <p><i>[Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip; [Ref: 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj UET-it dhe ka përmbushur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni brenda 6 (gjashtë) muajsh me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UET, me suplementin e diplomës, të firmosura nga Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm. Mbështetur në DVV, GVJ konstatoi se IAL ndjek hapat</p>



	e duhur deri në pajisjen me diplomë të të diplomuarve, dhe lëshimin e një vërtetimit për diplomën e fituar, të shoqëruar me çertifikatën e notave në rast kërkesë.  [Ref: 5. Rregullore e UET, Neni 40]
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi që në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, të cilën e tërheq pranë sekretarisë mësimore. Ky kriter përmbushet plotësisht.  [Ref: 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit]
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi që në përfundim të programit të studimit çdo student pajiset me diplomën sipas profilit përkatës, suplementin e diplomës; listën e notave dhe sipas kërkesës nga një kopje të syllabuseve për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit.  [Ref: 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore; Ref: 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit]
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	GVJ mbështetur në dokumentacion konstatoi që IAL ka arkivuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Arkivimi i dokumentacionit është i ruajtur në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>
	<b>Përmbushet kryesisht</b>
	<b>Përmbushet plotësisht</b>
	X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>
	<b>Përmbushet kryesisht</b>
	<b>Përmbushet plotësisht</b>
	X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të	Të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit mblidhen dhe administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore. GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita në institucion që UET disponon një listë të plotë të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi për të gjithë periudhën nga akreditimi i mëparshëm. Dosjet e personelit akademik përditësohen çdo vit me produktet e veprimtarsë së tyre kërkimore-shkencore, realizimin e ngarkesës mësimore dhe aktivitete shkencore të pritshme. Mbledhja e të dhënave për ngarkesën në auditor bëhet mbi



<p>studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>bazën e një formulari tip, i cili plotësohet nga personeli akademik me kohë të plotë dhe dorëzohet në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Të dhënat e personelit ruhen në dosje personale në ZBNj. Departamenti menaxhon gjithashtu atë pjesë të të dhënave që lidhet me veprimtarinë mësimore dhe kërkuese-shkencore të personelit akademik. Në faqen e internetit të IAL-së janë të publikuara CV e personelit akademik.<sup>20</sup></p> <p>GVJ kontrolloi në mënyrë rastësore dy dosje të personelit akademik të anagazhuar në këtë program studimi dhe konstatoi që dokumentacioni ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të institucionit.</p> <p><i>[Ref. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore; Ref. 11.2. Formulari i planifikimit të ngarkesës nga departamenti; Ref. 44.1 Format Dosje, Staf Akademik me Kohë të Plotë]</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UET ka procedura të miratuara për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe Kodin e Punës në RSH. Kriteret kryesore që duhet të plotësojnë kandidatët, përzgjedhja e tyre për konkurs dhe mënyra e zhvillimit të konkursit janë të përcaktuara në rregulloren për burimet njerëzore. Procedurat e rekrutimit zbatohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Vendet vakante publikohen në faqen e UET. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që DBNj zbaton me rigorozitet procedurat për rekrutimin e stafit, të cilat janë të hapura, transparente dhe i japin përparësi përthithjes së personelit akademik me tituj dhe grada.</p> <p><i>[Ref. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore, pika G.I.2, fq. 107; G.I.8 dhe G.I.9, fq. 108; Ref. 11.1. Shembull thirrje për staf akademik]</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Nevojat për personel akademik identifikohen nga Departamenti i cili paraqet propozimin në Dekanat. GVJ konstatoi që rregullorja për burimet njerëzore nuk përmban kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit. Kjo verifikohet dhe nga evidenca e paraqitur si shembull thirrje për stafin akademik.</p> <p><i>[Ref. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore, pika G.I.2, fq. 107; Ref. 11.1. Shembull thirrje për staf akademik]</i></p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rregullore për burimet njerëzore përmban procedurat që të ndiqen për rekrutimin e personelit akademik. Nevojat për vende të reja hapen me vendim të Bordit të Administrimit. Propozimin për hapjen e vendeve të reja të punës e miraton Dekanat dhe e paraqet në ZBNj, e cila ndjek zbatimin e procedurave të rekrutimit, nga shpallja e pozicionit deri tek lidhja e kontratës. Pozicionet e lira bëhen publike në faqen e internetit të IAL. Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga UET, takimin me personelin akademik dhe personelin e ZBNj, GVJ konstatoi që institucioni ka miratuar dhe zbaton procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit.</p>

<sup>20</sup> <https://uet.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-biznesit-dhe-zhvillimit/>



	[Ref. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore, pika G.I.2, fq. 107; Ref. 11.1. Shembull thirrje për staf akademik]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Institucioni e ka zhvilluar veprimtarinë e tij gjatë kësaj periudhe në dy mjedise të ndryshme. Në të dy mjediset UET ka patur zyra të dedikuara për personelin akademik, për drejtuesit e institucionit, të Njërive Kryesore dhe atyre Bazë, si dhe për personelin ndihmës akademik dhe atë administrative. Aktualisht institucioni ka mjedise të përshtatshme dhe të bollshme për personelin sipas të gjitha kategorive (58 zyra me sipërfaqe të përgjithshme 1481m<sup>2</sup>). Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi që infrastruktura ekzistuese i plotëson kushtet dhe është e përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Sekretaria mësimore, Biblioteka, etj. janë të akomoduar në salla të dedikuara, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të tyre.</p> <p>[Ref. 42. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit</i> Blv. Gjergj Fishta; Ref. 42.1. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit</i> Rr. Xhanfize Keko]</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Mbështetur në evidencat për trajnimet GVJ konstatoi që IAL organizon trajnime në fushën e kërkimit shkencor dhe trajnime profesionale për personelin për zhvillimin akademik e profesional të tyre. Në fushën e kërkimit trajnimet konsistojnë kryesisht tek metodologjitë e kërkimit dhe janë të dedikuara sipas kualifikimit që ka personeli. Ndërsa trajnimet profesionale kanë karakter praktik dhe përfshijnë kryesisht njohjen e rregulloreve të institucionit dhe dokumente të tjera bazë; trajnime në lidhje me aftësitë menaxhuese për stafin drejtues; trajnime mbi projektet dhe aftësimi i stafit për të hartuar një koncept-note apo të shkruajnë projekte, etj. GVJ konstatoi nga dokumentacioni dhe gjatë vizitës në institucion që IAL ka organizuar sistematikisht trajnime me personelin akademik duke adresuar nevojat e tyre.</p> <p>[Ref. 33. <i>Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët e diplomuar</i>; Ref. <i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i>]</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi që IAL ka organizuar gjithashtu trajnime specifike për kualifikimin e stafit për përdorimin e teknologjive të reja në procesin mësimor si (platformat Teams, LMS); si dhe trajnime mbi metoda inovative të mësimdhënies, etj.</p>



	[Ref. Ref. 33. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët e diplomuar; Ref. 46.2 UET LMS - Guide per pedagogun; Ref. 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS_LMS]		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Ngarkesa vjetore e personelit akademik planifikohet nga Departamenti që është përgjegjës për programin e studimit. Nga shqyrtimi i evidencave GVJ konstatoi që në vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar në këtë program studimi 11 personel akademik, nga të cilët 4 janë PAK. PAE i angazhuar në PS mbulon ngarkesë mësimore totale në auditor në intervalin 213 orë deri në 285 orë, ndërsa personeli akademik me kontratë ka ngarkesë vjetore të ultët. GVJ gjykon që ngarkesa është në përputhje me Udhëzimin nr. 29, datë 10/09/2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL".  [Ref. 24. Ngarkesa e personelit akademik te programit (tabela 4)]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UET është zhvendosur në mjedise të reja në vitin akademik 2021-2022. Aktualisht aktiviteti i institucionit zhvillohet në tre godina, që ndodhen në të njëjtin oborr me sipërfaqe totale 7545m <sup>2</sup> . UET ka në dispozicion të mësimdhënies 15 salla leksioni dhe 13 salla seminaresh. GVJ vizitoi të gjitha mjediset dhe konfirmoi që ato plotësojnë normativat teknike dhe janë të përshtatshme për mësimdhënie për këtë program studimi. Biblioteka gjithashtu ishte në një mjedis të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme.  [Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta; Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko; Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion]
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ konfirmoi gjatë vizitës në institucion që auditorët ishin të gjithë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme (tabela, videoprojektor dhe PC) të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Të gjitha ambientet ishin të mbuluara me sinjal WiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht internetin.  [Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta; Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko; Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion]



<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ konstatoi gjithashtu që IAL ka investuar për sistemet TIK, të cilat mbështesin studentët dhe personelin akademik në procesin mësimor. Përmes sistemit MOODLE (UET LMS) bëhet e mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio-vizive etj. Përmes këtij sistemi studentët kanë mundësi të komunikojë me pedagogët, të ndjekin kolegët e kursit, të shikojë notat dhe pikët on-line kudo që ndodhen. Në funksion të realizimit të programeve të studimit institucioni ka në dispozicion 7 laboratorë informatike dhe 9 laboratorë mësimor. Për të munduruar një proces efektiv të mësimdhënies dhe mbështetur studentët në veprimtarinë mësimore dhe kërkimore, janë instaluar programe kompjuterike, që mund të përdoren dhe nga studentët e programit të studimit "Master Profesional në Menaxhim Biznesi".</p> <p><i>[Ref. 46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS; Ref. 46.2 UET LMS - Guide per pedagogun; Ref. 46.3 UET_LMS_Guide per studentet]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucionin GVJ konfirmoi që IAL ka 7 laboratorë informatike, në pajisjet e të cilave janë instaluar programet e nevojshme për të realizuar një proces mësimdhënie efektiv. Studentët kanë akses në laboratore dhe mund t'i përdorin për të realizuar detyrat e kursit, esetë dhe punimet e diplomës.</p> <p><i>[Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko; Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Praktika profesionale është lëndë në planin mësimor. Sipas planit 8 orë zhvillohen në auditor dhe 120 orë në institucione dhe sipërmarrje të ndryshme. GVJ konstatoi që institucioni ka mjedise për realizimin e asaj pjese të praktikës që zhvillohet në auditor, ndërsa për pjesën tjetër ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me sipërmarrje dhe institucione që mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale.</p> <p><i>[Ref. 14.2 Plani mesimor i programit shqip; Ref. 32. Lista e Subjekteve dhe Institucioneve bashkepunuese per programin e studimit dhe praktikat profesionale; Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko; Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p><b>Standardi IV.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke</p>	<p>Në mjediset e institucionit ndodhet biblioteka me sipërfaqe totale 91m<sup>2</sup>, e ndarë në dy mjedise me 41 vende leximi. Mjediset e bibliotekës mund të shfrytëzohen nga të gjithë studentët. Studentët mund të antarësohen</p>



<p>garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>për të shfrytëzuar fondet e bibliotekës. GVJ vizitoi bibliotekën dhe kostatoi që ambjenti ishte i hapur, me ndriçim natyral, me tavolina të vendosura në distance për një shfrytëzimi të mjedisit në mënyrë optimale. Fondi i librave ishte i hapur dhe mund të konsultohet lirshëm nga studentët. Në sallën e bibliotekës ishin të instaluar dhe PC, të cilat mund të përdoren për të aksesuar bibliotekat online (SAGE dhe EBSCO). Studentët mund të regjistrohen dhe të tërheqin libra nga fondi i bibliotekës.</p> <p><i>[Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko; Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas DVV dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi që biblioteka është e pajisur me literaturë fizike, ku përfshihen tekste mësimore që përdoren si literature bazë, tekste ndihmëse në gjuhë shqipe dhe të huaj; si dhe periodik të huaj dhe vendas. Biblioteka ka 1708 tituj në funksion të programeve mësimore të Fakultetit të Ekonomisë Biznesit dhe Zhvillimit. Në fondet e bibliotekës ka dhe tekste origjinale apo përkthime të botuara nga UET press. Fondi i librave pasurohet nga viti në vit.</p> <p><i>[Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta; Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko; Ref. 45. Lista e inventarit të Bibliotekës të programit MP Menaxhim Biznesi; Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ konstatoi që IAL ka anëtarësim të plotë në 4 platforma online (SAGE, EBSCO, ASTM Compas dhe Edward Elgar Publishing). Në bibliotekë ka PC dhe lidhje me internet, që mundëson shfrytëzimin e fondeve falas nga studentët në mjediset e bibliotekës. <b>Megjithatë, GVJ sugjeron përdorim konkret të statistikave për të analizuar frekuentimin e bibliotekave online nga ana e studentëve.</b></p> <p><i>[Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta; Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko; Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ konstatoi që në PC e vendosura në sallë ishin instaluar programet e nevojshme kompjuterike, të cilat mundësonin shfrytëzimin e literaturës nga ana e studentëve.</p> <p><i>[Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Procedurat për pasurimin e bibliotekës janë parashikuar në dokumentin mbi funksionimin e bibliotekës. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstatoi që IAL pasuron vazhdimisht fondin e librave përmes blerjeve në vite. Kërkesat për tituj të rinj bëhen nga Departamentet dhe miratohen nga administratori. Shtimi i fondeve përmes blerjeve të titujve të rinj ose ribotimeve është praktikë e mirë, e cila duhet të vazhdojë, pasi mundëson jo vetëm shtimin e titujve, por dhe përditësimin e literaturës.</p>



	<i>[Ref. 45.1. Dokumenti E-IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës, E.IV.4, fq. 82; Ref. 45.2. E-IV-2 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke; Ref. 45.3. Shembull procedure_blerje literature]</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi që biblioteka është e hapur gjashtë ditë të javës. Orari i bibliotekës është çdo ditë të javës 09:00 – 20:00 dhe ditën e Shtunë 10:00-17:00. Oraret e shërbimit janë përshtatur me programet e studimit në të dy ciklet e studimit. Gjatë sezonit të provimeve shërbimi i bibliotekës është me orar të zgjatur.  <i>[Ref. 45.1. Dokumenti E-IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës, E.IV.2.8, fq. 81]</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sipas evidencave në DVV, Zyra e Regjistrimit të Studentëve dhe Sekretaria Mësimore mbajnë të dhënat e studentëve që nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Të dhënat personale të studentëve ruhen në regjistra dhe në sistemin elektronik të menaxhimit të universitetit (UMIS). Personeli akademik trajnohet për përdorimin e tij. Gjatë vizitës në sekretarinë e UET, GVJ konstatoi që të dhënat ruhen në regjistra dhe në sistemin e menaxhimit.  <i>[Ref. 2. Statuti i UET, neni 53, fq. 29-30; Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS; Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nga evidencat në DVV, GVJ konstatoi që UET përdor dy sisteme për menaxhimin e informacionit, të cilat janë të integruara. Sistemi UMIS ku menaxhohet gjithë dokumentacioni dhe informacioni i institucionit si statuti, rregulloret, dokumentat strategjike, dhe çdo dokument që lidhet me veprimtarinë e personelit. Ndërsa sistemi LMS (Learning Management System) menaxhon informacionin që ka të bëjë me procesin mësimor. Sistemi i fundit shërben gjithashtu për komunikimin e personelit dhe studentëve.  <i>[Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS; Ref. 46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS; Ref. 46.5. Raport ecuria e mësimin online, fq.1]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i brendshëm i menaxhimit (UMIS) siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente për të gjithë personelin. Ndërsa sistemi LMS (Learning Management System) siguron akses të dedikuar për personelik akademik dhe studentët në të gjitha programet e studimit. Çdo



	<p>përdorues ka kodin dhe fjalëkalimin e tij në sistemin dhe merr informacione të dedikuara në varësi të statusit.</p> <p>[Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS; Ref. 46.2 UET LMS - Guide per pedagogun; Ref. 46.3 UET_LMS_Guide per studentet]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni përdor një sistem të menaxhimit të mësidhënies (UET LMS) që lehtëson gjithashtu komunikimin interaktiv dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis personelit akademik dhe studenteve në kohë reale. Sistemi është një version i përshtatur i Moodle dhe i integruar me sistemin e brendshëm të menaxhimit të institucionit (UMIS). Sistemi mundëson aksesin, koordinimin dhe organizimin e lëndëve në internet. GVJ konstatoi që studentët dhe personeli akademik mund të identifikohen në LMS duke përdorur llogarinë zyrtare të email-it dhe përmes platformës mund të kenë komunikime interaktive.</p> <p>[Ref. 46.5. Raport ecuria e mësimin online; Ref. 46.2 UET LMS - Guide per pedagogun; Ref. 46.3 UET_LMS_Guide per studentet]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>GVJ konstatoi mbështetur në DVV që sistemi LMS mundëson monitorimin e aktivitetit akademik në kohë reale. Nga sistemi janë gjeneruar raporte të cilat kanë tregues të rëndësishëm për monitorimin e të gjithë aktivitetit akademik. GVJ konstatoi gjithashtu që raportet janë gjeneruar kryesisht në periudhë kur mësimi është zhvilluar online. Ndërsa për monitorimin e aktivitetit administrative nuk ka evidence.</p> <p>[Ref. 46.5. Raport ecuria e mësimin online; 46.6 Raportimet javore të mësimin online-DMM]</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>GVJ vizitoi faqen e internetit të UET-së dhe konstatoi që institucioni ka të publikuar në mënyrë të përmbledhur dhe të strukturuar shumë mirë të gjithë informacionin që lidhet me veprimtarinë e universitetit, programet e studimit, personelin akademik sipas fakulteteve dhe departamenteve; informacionin mbi pranimet, bursat, transferimet dhe aplikimin e studentëve; informacionin mbi kërkimin shkencor, projektet dhe partnerët; si dhe shërbimet për studentët. Informacioni është i publikuar në dy gjuhë: shqip dhe anglisht dhe është i përditësuar.</p> <p>[Ref. <a href="https://uet.edu.al/">https://uet.edu.al/</a>; Ref. <a href="https://uet.edu.al/en/master-profesional/">https://uet.edu.al/en/master-profesional/</a>; Ref. <a href="https://uet.edu.al/en/fakulteti-i-ekonomise-biznesit-dhe-zhvillimit/">https://uet.edu.al/en/fakulteti-i-ekonomise-biznesit-dhe-zhvillimit/</a>; Ref. <a href="https://uet.edu.al/en/#">https://uet.edu.al/en/#</a>]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

61



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UET harton për çdo vit pasqyra financiare sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit. Pasqyrat janë të konsoliduara dhe përfshijnë të gjithë aktivitetin e kompanisë (E.E.I. sh.p.k). Burimet kryesore të të ardhurave që gjenerohen nga shërbimi arsimor janë tarifatat për dhe gjatë shkollimit, donacionet dhe aktivitetet tregtare. GVJ konstatoi mbështetur në DVV që institucioni nuk harton raport financiar të veçantë për çdo program studimi. Sipas DVV kostoja mesatare për student në vitin akademik 2020-2021 ka qënë 150.397 lekë dhe ajo është ulur për periudhën midis dy akreditimeve.</p> <p><i>[Ref. 50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2); Ref. 49. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1)]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiarë grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Siç u evidentua në kriterin 1, institucioni harton pasqyra financiare të konsoliduara dhe në këto pasqyra evidentohen të gjitha shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, shpenzimet operative dhe shpenzimet kapitale. Në pasqyrat financiare janë të përfshira gjithashtu të ardhurat nga të gjitha burimet, të cilat janë lehtësisht të lexueshme.</p> <p><i>[Ref. 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime, fq. 14-17; Ref. 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime; Ref. 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>GVJ konstatoi mbështetur në DVV që E.E.I. sh.p.k (pjesë e të cilit është dhe UET) ka kryer auditim çdo vit me auditues të licensuar. Audimi është mbështetur në pasqyrat financiare, të cilat përmbajnë pasqyrën e të ardhurave, shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, etj. Pasqyrat financiare përmbajnë gjithashtu të ardhurat nga tarifatat e shkollimit dhe kontribute të tjera financiare për studentët, si dhe burimet e tjera financiare.</p> <p><i>[Ref. 50.4 Raport auditimi viti 2018; Ref. 50.5 Raport auditimi viti 2019; Ref. 50.6 Raport auditimi viti 2020; Ref. 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime, fq. 14-17; Ref. 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime; Ref. 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Mbështetur në DVV, GVJ konfirmoi që institucioni dokumenton aktivitetin e të gjithë kompanisë përmes pasqyrave financiare. Burimet e të ardhurave janë të diversifikuara. Tarifatat e studimit përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave. Ecuria dhe mbarëvajtja e programeve garantohej nga numri i regjistrimeve në secilin nga programet e studimit.</p> <p><i>[Ref. 50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2); Ref. 50.4 Raport auditimi viti 2018; Ref. 50.5 Raport auditimi viti 2019; Ref. 50.6 Raport auditimi viti 2020; Ref. 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime, fq. 14-17; Ref. 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime; Ref. 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime]</i></p>






<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Mbështetur në pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit, GVJ konstatoi që institucioni garanton qëndrueshmëri financiare dhe ka kapacitete për të gjeneruar të ardhura për shërbimin arsimor, çka do të ndikonte në përmirësimin e situatës financiare të institucionit.</p> <p><i>[Ref. 50.4 Raport auditimi viti 2018; Ref. 50.5 Raport auditimi viti 2019; Ref. 50.6 Raport auditimi viti 2020; Ref. 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime, fq. 14-17; Ref. 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime; Ref. 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	------------------------------	-----------------------------	--

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p><b>Standardi V.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi që IAL harton politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentit, i cili pajis studentin me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Programi i studimit "Master Profesional Menaxhim Biznesi" është i organizuar me 60 kredite formimi. Gjuha e zhvillimit të programit mësimor është gjuha shqipe.</p> <p>Njëkohësisht institucioni i publikon kriteret e pranimit të studentëve në faqen zyrtare web (www.uet.edu.al) në përputhje me politikat institucionale. Gjithë informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese (Guida UET), fushatat informuese mediatike, si edhe gjatë këshillimit në institucion.</p> <p>Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura të detajuara si: Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin; Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik. Ky kriter plotësohet.</p> <p><i>[Ref: 2. Statuti i UET; Ref: 5. Rregullore e UET, Kreu 3, Neni 11, pika 1.; Ref: 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Ref: 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik; Ref: 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin]</i></p>





<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion, konstatoi që PS siguron të drejta të barabartë. Pra institucioni dhe program siguron që politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Pra ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>[Ref: 5. Rregullore e UET, Kreu 3, Neni 11 dhe Neni 28; Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip]</p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku nëpërmjet këtyre kanaleve: 1- në faqen zyrtare web (www.uet.edu.al) të institucionit; 2- kontaktit të studentëve me zyrën e pranimit dhe me pedagogët e këshillimit të karrierës. Pas verifikimeve dhe në webin zyrtar, GVJ është i mendimit se IAL bën të mundur publikimin e të gjithë informacioneve të nevojshme.</p> <p>[Ref: 5. Rregullore e UET; Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion]</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për tëu pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi që IAL harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për tëu pranuar në ciklin e dytë të studimeve, specifikisht ne Master Profesional në "Menaxhim Biznesi", të cilat gjenden në faqen zyrtare të institucionit, dhe në Dokumentin D.I Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studenteve.</p> <p>[Ref: 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studenteve]</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion konstatoi që IAL përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit nëpërmjet informacionit në website-n e tij, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit me zyrën e pranimeve, takimeve me studentët potencialë (gjimnaz tour), etj.</p> <p>[Ref: 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Ref: 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik]</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi se IAL nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së këshillimit të karrierës dhe sekretarisë, institucioni vë në dispozicion dhe ofron informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret, procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe shtyrjes së studimeve në një vit tjetër akademik. Kohëzgjatja normale e programit Master Profesional zgjat një vit akademik.</p> <p><i>[Ref: 5. Rregullore e UET; Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, pika 2 dhe pika 3.2]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së përkujdesit për studentët, zyra e këshillimit të karrierës, sekretarisë dhe departamentit përkatës, institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme. Rregullorja përcakton qartë se cilat kritere duhet të përmbushen nga studimet e mëparshme të studentit. Procedura e transferimit nga bërja e kërkesës me shkrim nga studenti, deri në njohjen e lëndëve dhe regjistrimin e tij në këtë program studimi janë të përcaktuara në dokumentin D.II "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin".</p> <p><i>[Ref: 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në Rregulloren mësimore të programit të studimit Master Profesional Menaxhim Biznes shprehet qartë menyrë e vlerësimit të dijeve në lëndët përkatëse në përputhje me tipologjinë e tyre. Gjithashtu, syllabuset e seciles lëndë, jep informacion te detajuar për vlerësimin e njohurive dhe aftësive.</p> <p>Studentët e aksesojnë atë në mënyrë direkte në UET- LMS dhe në cdo moment pranë zyrës së sekretarisë ose koordinatorëve të programit të studimit specifik.</p> <p>Pas takimit me stafin dhe studentët, GVJ shpreh përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>[Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, pika 2 dhe pika 3.2; Ref: 19. Syllabuset e Lëndëve të ofruara për programin Master Profesional në Menaxhim Biznesi; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me studentët e programit të studimit Master Profesional]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi shpërndarjen e informacionit të duhur për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Dokumenti për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike, e deri te formatimin konkret të punimit, dorëzimin dhe mbrojtjen. Fazat kohore të</p>




	dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik.			
	[Ref: 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit; Ref: 10.1. Kalendarit akademik 2018-2019]			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi se IAL përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura, si takime me studentet potenciale, aktivitete (UET open days, shkollat verore e dimërore), për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Gjatë Ditëve të Hapura çdo Fakultet orjenton studentët e ardhshëm mund të marrin pjesë e të njihen nga afër me ambientet, pedagogët dhe mësimdhënien.			
	[Ref: 5. Rregullore e UET]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi që IAL siguron informimin të hollësishëm në lidhje me detajet e strukturës, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. Që në momentin e aplikimit, regjistrimit por edhe në vazhdim, studentët marrin informacionin e duhur për programit të Master Profesional në "Menaxhim Biznesi" nga zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës dhe pedagogët. Ky informacion gjendet i publikuar në UET-LMS.  [Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me studentët e programit të studimit Master Profesional]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët e programit të studimit kanë në dispozicion informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Këto informacione dhe dokumenta merren dhe gjenden në zyrën e sekretarisë dhe koordinatoreve, në UET-LMS, në website-n e institucionit. Gjithashtu në fillim të secilit semestër studentët pajisen në formatë ndryshme të shkruara dhe elektronike me të gjithë syllabuset e lëndëve. Tutoriati është një shërbim që iu ofrohet studentëve të ciklit të dytë dhe synoni ndihmë ata të identifikojnë dhe të arrijnë qëllimet e tyre akademike. Këshillimi akademik është një proces në shërbim të studentëve, për të sqaruar çdo paqartësi ose vështirësi që mund të haset nga studenti



	<p>për shlyerjen e detyrimeve në lëndët që ai frekuenton. Ky informacion u konfirmua dhe nga takimet më vete studentët dhe zyrat përkatëse.</p> <p><i>[Ref: 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacionin përkatës, komstatoi se me anë të Zyrës së Këshillimit të Karrierës, IAL ofron këto shërbime kryesore: Këshillim të vazhdueshëm për studentët, duke i mbështetur në hartimin e CV, Letrës së motivimit &amp; Korrespondencën me zyrat e Burimeve Njerëzore të kompanive/organizatave; letrës së falenderimit, letrës së refuzimit të pozicionit, (trajtime online dhe offline); b. Këshillim të studentëve për faza të intervistës së punës; c. Përgatit kalendarin e eventeve të lidhura me industrinë – Open Day për çdo fakultet dhe panaiet e punës; d. Zhvillon sondazhin e planit të karrierës së studentëve. –raporti të ndihmon të kuptosh punësimin - burimin, intershipet – burimin dhe planet e karrierës së studentëve, e. Zhvillon sondazhin e besnikërisë ndaj UET; f. Mentorim &amp; Networking (të gjitha burimet, partneritete të universitetit, panaiet e punës, Alumni, Bordet e Tregut të punës; grupi i studentëve në LinkedIn, netëork i studentëve që kanë bërë internship dhe Erasmus) g. Gjurmim studentët pas diplomimit dhe përpunon statistika mbi Alumnin; sa integrohen në tregun e punës, vazhdojnë studimet, etj.; h. Database me burime të mundësive të ndryshme për punësim, internship, bursa studimi, etj, duke i shpërndarë njoftimet tek studentët për të cilët mund të kenë interes. i. Organizimi i proceseve të rekrutimit në universitet. Pra institucioni siguron orientimin konkret drejt tregut të punës.</p> <p><i>[Ref: 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion konstatoi se studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij nga zyrat përkatëse të kujdesit ndaj studentëve, sekretaria dhe kordinatorët përkatëse, por edhe online, nëpërmjet UET-LMS. Njëkohësisht UET organizon procesin e Tutoriatit dhe këshillimin akademik të shpallur që në fillim të vitit.</p> <p><i>[Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip; Ref: 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore; Ref: 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Ref: 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit gjendet në sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit (UET-LMS) dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët jo vetëm në ambientet e institucionit por edhe në distancë, nëpërmjet kompjuterit dhe smartphone. GVJ mbështetur në dokumentacionin përkatës, konstatoi se ky informacion është gjithashtu publik përmes website të Fakultetit.</p>





	<i>[Ref: 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS]</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	GVJ është i mendimit se referuar dhe dokumentacionit të dorëzuar PS disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Master Profesional në "Menaxhim Biznesi". Ky program vuri në dispozicion të GVJ detajet në lidhje me statistikat vjetore në rang fakulteti dhe departamenti, ku ishte një analizë e detajuar në lidhje me studentët e diplomuar ndër vite. Analizat statistikore daton nga periudha 2018-2019 dhe 2019-2022. Nëpërmjet Bordit të Tregut të Punës i përbërë nga studentët Alumni, në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithësecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës.  <i>[Ref: 29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. GVJ shqyrtoi dokumentacionin përkatës ku pa statistikat e detajet për çdo profil për gjashtë vitet e fundit, duke përfshirë dhe atë të vitit akademik 2021-2022.  <i>[Ref: 27. MP Menaxhim Biznesi _Cilësia në hyrje dhe dalje]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Sekretaria mësimore disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve Master Profesional në "Menaxhim Biznesi" që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre duke mbajtur në sistem të dhëna për prezencën, vlerësimin dhe stadin ku ndodhet një student lidhur me programin që ndjek. Kjo u konstatua dhe nga vizita që GVJ kishte pranë sekretarisë mësimore.  <i>[Ref: 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore; Ref: 29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit (soft copy dhe hard copy) dhe janë të sigurta



informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, IT dhe sekretaria nëpërmjet UMS, sekretaria (kopje fizike të procesverbaleve. GVJ verifikoi dokumentacionin e ruajtur përmes sistemit UMS si dhe përmes kopjeve të printuara, të cilat disponoheshin nga sekretaria mësimore.  [Ref: 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore; Ref: 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS]		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Institucioni harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Në analizën e bërë reflektohen notat më të larta dhe më të ulta të studentëve të diplomuar. <b>Si vlerë e shtuar në analizën statistikore, e cila u vu në dispozicion të GVJ, do sugjerohej të shtohet dhe analiza e masave që duhet të ndërmerren në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</b>  [Ref: 27. MP Menaxhim Biznesi _Cilësia në hyrje dhe dalje]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ kostatoi se IAL ka përcaktuar përfshirjen e studentëve në strukturat vendimmarrëse të institucionit, si psh. në Këshillin studentor, në fokus grupet e vlerësimit të lëndëve dhe pedagogëve, nëpërmjet vlerësimit online për pedagogun, në senatin akademik të UET, në Dekanat, Këshillin e Etikës, dhe Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Nga takimet që GVJ kishte me studentët e pa qartazi se studentët njiheshin të përfshirë në vendimmarje dhe në organizime të shumë eventeve akademike dhe jashtëkurrikulare.  [Ref: 5. Rregullore e UET, Kreu X, Neni 42, pika d, e]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia bazë garanton përfshirje konkrete në vendimmarje sic është përfshirja në qeverinë studentore), këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik me anë të vlerësimeve të stafit akademik dhe fokus grupeve. Këto të dhëna mbahen nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Nga takimi me përfaqësues të kësaj zyre u diskutuan në detaje të gjitha mënyrat e përfshirjes së studentëve në procese të ndyshme.



	[Ref: 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Ref: Datë 10.05.2022, Takimi 5: Takim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve]			
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar GVJ kostatoi se IAL mban parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit, ku çdo semestër ka 30 ECTS, dhe ka procedura joburokratike të njohjes së studimeve të mëparshme. Studentët informohen në lidhje me të gjitha procedurat dhe veprimi i tyre mbi bazën e këtyre procedurave duke gjetur mbështetjen e koordinatorëve të departamenteve, sekretarisë mësimore, etj. Ky kriter plotësohet.  [Ref: 5. Rregullore e UET, Neni 18; Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, pika 9]			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar GVJ kostatoi se PS organizon mbledhje të hapura, ku studentët kanë mundësinë të përfshihen në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit. GVJ shpreh përmbushjen e kriterit.  [Ref: 5. Rregullore e UET, Neni 42]			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia bazë u mundëson studentëve dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës. Pas çdo provimi organizohen dhe kryhen seancat sqaruese në të cilat studentët kuptojnë dhe komunikojnë me pedagogun përkatës lidhur me vlerësimin dhe mundësinë për rishikim të vlerësimit. Në rast ankimi, procedurat janë transparente dhe vlerësimi bëhet përmes një komisioni që ngrihet në nivel departamenti ose fakulteti.  [Ref: 5. Rregullore e UET, Neni 27 dhe Neni 42; Ref: 7. Rregullore e programit MP Menaxhim Biznesi shqip, pika 5.8]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet	Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi që IAL i ka përdorur forma zyrtare të komunikimit nëpërmjet emailit zyrtar (@uet.edu.al), që mbart cdo staf apo student. Të gjitha komunikimet bëhen nëpërmjet emailit zyrtar. Në vitin e parë të cdo programi studimi zyra e IT në UET iu komunikon të gjithë





<p>ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>studentëve që fillojnë ndjekjen për herë të parë të një programi studimi nga emaili i tyre personalet kredencialet lidhur me emailin zyrtar të uet dhe udhëzimet përkatëse për të personalizuar passwordin e krijuar nga zyra e IT fillimisht. Një mjet tjetër komunikimi është platforma UET LMS, ku studentët kanë akses për të syllabuset e lëndëve, materialet lidhur me leksionet dhe seminarët, orarin mësimor si dhe mundësinë për të komunikuar. Një tjetër platformë nëpërmjet të cilës mbledhet informacion lidhur me rezultatet e vlerësimit të studentëve për secilin modul që ndjekin është sistemi me të cilin punon sekretaria mësimore, UMS. Me gjerësisht, studentët informohen nëpërmjet faqes zyrtare në Web të UET dhe në zyrën e sekretarisë dhe kordinatorëve.</p> <p><i>[Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar GVJ kostatoi se IAL ka një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Kjo bëhet kryesisht nëpërmjet zyrës së kujdesit ndaj studentëve, dekanit të studentëve por edhe me anë të sistemit UET- LMSku ofrohen informacione të përditësuara për procesin mësimor dhe programin e studimit. Baza e të dhënave për studentin përfshin edhe e-mailin që shërben si një tjetër mjet për informim dhe këshillim nga zyrat përkatëse dhe kordinatorëve.</p> <p><i>[Ref: 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në UET funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit që ofron në mënyrë të vazhduar dhe periodike informacion dhe orientim të posaçëm, këshillim të karrierës lidhur me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Mbështetur në takimin me studentët dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konkludoi angazhimin e kësaj zyre në orientimin e studentëve në tregun e punës.</p> <p><i>[Ref: 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Ref. Datë 10.05.2022, Takimi 5: Takim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve; Ref: Datë 09.05.2022, Takimi nr. 5. Takimi me studentët e programit të studimit Master Profesional]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e</p>	<p>Në UET, zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit ndjek studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

  71



<p>mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>mbajtur të dhëna mbi punësimin e studentëve të programit të studimit në kuadër të funksionit të kësaj zyre, merren masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të studentëve nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat dhe firmat partnere të UET. Një urë tjetër lidhëse e të diplomuarve me institucionin janë dhe eventet e përbashkëta në kuadër të alumni si dhe leksionet e hapura në orientimin e karrierës. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludoi që zyra e karrierës në UET ka politika dhe procedura të miratuara të ndjekjes së studentëve dhe pas diplomimit.</p> <p><i>[Ref: 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
--	------------------------------	-----------------------------	--

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<p><b>Standardi VI.1</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në statutin e UET-së garantohet sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë (neni 11) dhe parashikohet ngritja e Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional (neni 16 fusha e veprimtarisë dhe përbërja e tij). Parimet, qëllimet, objektivat dhe mënyra e funksionimit të strukturave janë parashikuar në rregulloren mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë. Institucioni ka krijuar Drejtorinë e Standardeve dhe Cilësisë, në përbërje të së cilës është KSBC. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludoi që UET ka politika dhe proceduratë miratuara, si dhe ka ngritur struktura në përmbushje të kërkesave të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë në RSH" dhe akteve nënligjore.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti i UET, neni 11, fq.5; neni 16, fq.7; Ref. 2.2. Struktura organizative UET; Ref. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; Ref. 2.2. Struktura organizative UET]</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në UET përfshin strukturat (KSBC), rregulloren, procedurat, manualin dhe planin e veprimit të KSBC-së. Ngritja dhe funksionimi i strukturave është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në përbërje të KSBC ka personel akademik, personel ndihmës akademik, studentë dhe ekspertë të jashtëm. Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (2017-2022) është një dokument i rëndësishëm që sanksionin objektivat, organizimin dhe menaxhimin e sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Për arritjen e objektivave strategjik, institucioni ka miratuar planin e veprimit, i cili përmban aktivitete dhe periudhën e realizimit të tyre. Mbështetur në DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka ngritur një sistem të sigurimit të cilësisë që funksion në mënyrë të efektshme.</p> <p><i>[Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC; Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; Ref. 30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesisë; Ref. 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC]</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni i është nënshtruar vlerësimit të jashtëm (institucional dhe të programeve) në mënyrë periodike. IAL i është nënshtruar vlerësimit institucional tre herë dhe ka marr vlerësim pozitiv. Vlerësimit të jashtëm periodik i janë nënshtruar gjithashtu të gjitha programet e studimit në afat. PS "Master Profesional në Menaxhim Biznesi, me profile" është në procesin e riakreditimit periodik. Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm janë të publikuara në faqen e institucionit<sup>21</sup>. GVJ konstatoi që IAL përdor instrumentat e duhur për sigurimin e cilësisë, dhe kjo realizohet me përfshirjen e të gjitha strukturave.</p> <p><i>[Ref. 54.3. Vendimi i BA Nr. 12 date 07.04.2017 _akreditimi periodik fnstitucional; Ref. 54.4 VBA Nr.46 date 05.07.2019 Per Akreditimin e UET; Ref. 54.5 CERTIFIKATE AKREDITIMI 05.07.2019]</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>UET ka miratuar një strategji 5 vjeçare për sigurimin e brendshëm të cilësisë (2017-2022), si dhe plane veprimi vjetore me aktivitete dhe afate të përcaktuara për zbatimin e tyre. Mbështetur në DVV GVJ konstatoi që procedurat e monitorim/vlerësimit zbatohen në mënyrë periodike dhe gjetjet e monitorim vlerësimit i komunikohen drejtuesve të institucionit dhe gjithë personelit të UET. GVJ konkludoi se të gjitha masat e zbatuara nga institucioni dhe instrumentat e ndryshëm që përdoren i shërbejnë krijimit të kulturës së cilësisë në nivel institucional.</p> <p><i>[Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC; Ref. 30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesisë]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

## Standardi VI.2

<sup>21</sup> <https://uet.edu.al/raporte-vleresimi/>



**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>KSBC-ja dhe Zyra e Kurrikulave janë njësitë e posaçme të krijuara nga UET për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë. GVJ konstatoi që të dy njësitë bashkëpunojnë ngushtësisht me Njësinë bazë për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p> <p><i>[Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>UET ka procedura dhe instrumenta të miratuara të cilat përdoren nga KSBC-ja për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë. GJV konstatoi që procedurat e monitorimit dhe vlerësimit dokumentohen nga njësitë e ngritura përmes raporteve, të cilat iu vihen në dispozicion strukturave drejtuese, personelit akademik dhe aktorëve të tjerë të interesuar.</p> <p><i>[Ref. 30.5 Metodologjia e punes se KSBC provimet; Ref. 30.6 Format raporti per provimet; Ref. 30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>UET përdor instrumenta të ndryshme për të vlerësuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Mbështetur në DVV, takimin me personelin akademik dhe studentët GVJ konstatoi që disa nga instrumentat e përdorur janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyetësorët me studentët, të cilat plotësohen në fund të çdo semestri. Studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe përmbajtjen e lëndës.</li> <li>• Vlerësimi i syllabuseve;</li> <li>• Vlerësimi i personelit akademik;</li> <li>• Fokus grupe me studentët;</li> <li>• Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues të programit të studimit;</li> <li>• Raporti vjetor institucional i cili përmban informacione dhe analiza mbi treguesit kryesorë të performancës së programeve të studimit, siç është kalueshmëria dhe nota mesatare, përmes të cilave maten rezultatet e të nxënit.</li> </ul> <p><i>[Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC; Ref. 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit te pedagogut nga eprori-kolegu; Ref. 40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët; Ref. 37. Format i relacionit për monitorimin e silabuseve; Ref. 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese; Ref. 56.1. Raporti Vjetor Institucional 2020-2021, fq.79-80]</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e instrumentave monitorues dhe vlerësues përpunohen dhe dokumentohen nga strukturat përgjegjëse dhe përmblihen në formën e raporteve si raporti i departamentit dhe raporti vjetor. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që rezultatet e vlerësimeve u bëhen të njohura strukturave përgjegjëse dhe vendimmarrëse për PS.</p> <p><i>[Ref. 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese; Ref. 56.1. Raporti Vjetor Institucional 2020-2021, fq.79-80]</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi që disa instrumenta vlerësimi kanë elementë të matjes së rezultateve të pritshme dhe përmbajnë sugjerime për përmirësim, por nuk evidentoi se si reflektohen ato në raportet vjetore. Për këtë program studimi janë lënë rekomandime nga akreditimi i parë, por për të adresuar mangësitë dhe përmirësimet e nevojshme nuk është hartuar një plan veprimi i veçantë. <b>GVJ rekomandon që KSBC duhet të përfshijë në të gjitha raportet periodike të vlerësimit rezultatet dhe masat e marra për adresimin e mangësive të evidentuara gjatë monitorimit /vlerësimit.</b></p> <p><i>[Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; Ref. 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu; Ref. 30.8.1. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu i plotësuar]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Programi i studimit "Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profile" është vlerësuar në mënyrë periodike. Programi i nënshtrohet vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm për here të tretë. Në të gjithë këtë proces departamenti është mbështetur nga KSBC. Rezultatet e mëparshme të vetëvlerësimit janë përfshirë në raportet e vlerësimit institucional. Departamenti bën gjithashtu në mënyrë periodike një raport, që analizon arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. GVJ mbështetur në DVV dhe vizitën në IAL konstatoi që vlerësimi i programit është kryer në mënyrë periodike dhe informacioni është përfshirë në raportin e vetëvlerësimit institucional.</p> <p><i>[Ref. 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese; Ref. 56.1. Raporti Vjetor Institucional 2020-2021]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në</p>	<p>Institucioni përdor metoda dhe instrumenta të ndryshëm për kryerjen e vlerësimit si: pyetësorët me studentët, vlerësimin e syllabuseve; vlerësimin e personelit akademik; fokus grupe me studentët; etj. GVJ</p>



<p>përputhje me natyrën dhe specifikhën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që instrumentat e përdorur i përshtaten fushës akademike të programit të studimit dhe përdoren periodikisht nga IAL.</p> <p><i>[Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC; Ref. 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu; Ref. 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët; Ref. 37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve]</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtëpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UET përdor disa metoda të drejtëpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit si: vlerësimi i syllabuseve, vizitat në auditor nga titullari i Njësisë bazë dhe Njësisë kryesore, rishikimi periodik i programit të studimit, vlerësimi i arritjeve të personelit akademik në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, vlerësimi i arritjeve të studentëve (nota mestare dhe kalueshmëria), etj. GVJ konstatoi që IAL përdor metoda të drejtëpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, të cilat përdoren periodikisht, dokumentohen përmes raporteve dhe iu dërgohen autoriteteve drejtuese.</p> <p><i>[Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC; Ref. 37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve; Ref. 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese; Ref. 56.1. Raporti Vjetor Institucional 2020-2021, fq.78-80]</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni përdor gjithashtu disa instrumenta të tërthortë për të vlerësuar cilësinë e programit të studimit si pyetësori i vlerësimit të studentëve për pedagogun dhe lëndën; vlerësimi i personelit akademik nga eprori, pyetësori me stafin, fokus grupet me studentët. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen dhe i shërbejnë vlerësimit të mbarëvajtjes së programit të studimit. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe takimet në institucion konstatoi që instrumentat e tërthorta përdoren në mënyrë periodike dhe i shërbejnë përmirësimit të cilësisë të programit të studimit.</p> <p><i>[G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu; Ref. 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e</p>	<p>Statuti i UET parashikon ngritjen e KSBC-cë si struktura përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë. Statuti parashikon që në Komision të sigurohet përfaqësimi i personelit</p>



<p>aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>akademik, ndihmës akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm. Sipas dokumentacionit në DVV, KSBC përbëhet nga 12 anëtarë, nga të cilët 8 (tetë) janë personel akademik me kohë të plotë nga çdo njësi kryesore dhe të paangazhuar në detyra të nivelit të lartë, dy personel ndihmës akademik, një përfaqësues i studentëve, si dhe një ekspert i jashtëm me përvojë në çështje të sigurimit të cilësisë. GVJ konstatoi që institucioni ka parashikuar dhe garantuar përfshirjen e të gjithë aktorëve në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti i UET, neni 16, fq. 7; Ref. 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Referuar DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konfirmon që UET ka struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat kanë detyra të përcaktuara qartë në statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Në statutin e UET dhe manualin për sigurimin e brendshëm të cilësisë specifikohen qartë organizimi dhe përbërja e KSBC-së, funksionet kryesore të saj. GVJ konstatoi që detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti i UET, neni 16, fq. 7; Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë, pika 2.1, fq.8]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion rezulton që UET ka garantuar përfshirjen e Njësisë bazë dhe Njësi kryesore në procesin e sigurimit të cilësisë. Gjatë vizitës në IAL, GVJ konfirmoi që në vlerësimin e programit të studimit janë përfshirë Fakulteti, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, antarët e personelit akademik përmes instrumentave të ndryshme direkt dhe indirekt të vlerësimit të brendshëm dhe studentët.</p> <p><i>[30.1. Plani veprimit KSBC]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që në proceset periodike të vlerësimit janë përfshirë drejtuesit Njësi kryesore dhe Njësi kryesore, personeli akademik dhe ndihmës akademik, KSBC dhe studentët. Të gjithë aktorët janë përfshirë në procesin e vlerësimit në mënyrë të pavarur, kanë dhënë kontributin e tyre përmes plotësimit të pyetësorëve dhe zbatimit të instrumentave të ndryshëm. GVJ konstatoi që në proceset e vlerësimit është respektuar integriteti akademik i personelit, të dhënat e grumbulluara nga studentët janë përdorur në mënyrë kofidenciale dhe nuk u identifikuan raste diskriminimi apo pabarazi.</p> <p><i>[Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Mbështetur në DVV dhe vizitën në institucion GVJ konstatoi që UET ka bërë pjesë aktive të procesit të sigurimit të cilësisë një anëtar/ekspert të jashtëm, si antar të KSBC-së dhe Bordin e Tregut të Punës, që ka në përbërjen e tij ekspert të fushave të ndryshme që lidhen me programin e studimit. GVJ mbështetur në evidenca konkludon që këta ekspertë mund të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p>



	[Ref. 12.1 Bordi i Tregut të Punës; Ref. 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Personeli i UET ka akses në strategjinë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, planin e veprimit të KSBC-se, manualin për sigurimin e brendshëm të cilësisë përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit. GVJ konstatoi që IAL mundëson transparencë maksimale për të gjitha procedurat dhe proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë për personelin. <b>GVJ rekomandon që e njëjta mundësi duhet të jepet për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</b>  [Ref. Shënime nga vizita në institucion]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstatoi që UET ka publikuar në faqen zyrtare raportet e vetvlerësimit dhe raportet e ekspertëve të jashtëm pas përfundimit të procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit. Gjithë aktorët e interesuar dhe publiku mund të njihen me këto raporte përmes faqes zyrtare të institucionit <sup>22</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni ka patur rekomandime nga akreditimi periodik, por GVJ nuk identifikoi një plan masash që ka shërbyer për të adresuar rekomandimet e Këshillit të Akreditimit për këtë program studimi. GVJ konstatoi që rekomandimet janë adresuar dhe shkalla e përmbushjes së tyre është pasqyruar në këtë raport. GVJ konstatoi gjithashtu që rekomandimet dhe statusi i plotësimit të tyre publikohen në raportet e vlerësimit të jashtëm dhe raportet e vetvlerësimit, të cilat janë në faqen e internetit të UET dhe faqen e ASCAL <sup>23</sup> . Sipas DVV Njësitë bazë hartojnë plane veprimi dhe në përgjigje të gjetjeve të vlerësimeve të brendshme që realizohen nga KSBC.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	KSBC vlerëson në mënyrë periodike veprimtarinë mësimore, punën kërkimore-shkencore, tërheq mendimin e studentëve dhe personelit në lidhje me cilësinë e programeve të studimit. GVJ konstatoi që vlerësimi realizohet në bashkëpunim me Njësitë bazë, Njësitë kryesore dhe Njësitë ndihmës akademike në nivel institucioni. Gjetjet e vlerësimit përfshihen në raportet vjetore të Njësisë bazë dhe në raportin vjetor të institucionit. Raportet diskutohen dhe miratohen në strukturat vendimarrëse. Raporti

<sup>22</sup> <https://uet.edu.al/raporte-vleresimi/>

<sup>23</sup> <https://uet.edu.al/raporte-vleresimi/>



	<p>vjetor i IAL përmban ndër të tjera dhe informacion mbi sigurimin e cilësisë dhe procesin e akreditimit.</p> <p>[Ref. 30.1. Plani veprimi KSBC: Ref. 56.1. Raporti Vjetor Institucional 2020-2021, fq.78-80]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>GVJ konstatoi që personeli ka akses të plotë në të gjitha informacionet që lidhen me sigurimin e cilësisë si: strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, manuali i sigurimit të cilësisë, planin e veprimi të KSBC-së dhe udhëzuesin e studentit, përmes të cilave marrin informacion mbi politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni. Përfshirja e personelit dhe studentëve në disa veprimtari dhe struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë ndikon në ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe personelit.</p> <p>[Ref. 30.1. Plani veprimi KSBC]</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Menaxhim Biznesi", me profile: "Menaxhimi i SME-ve", "Menaxhimi i Burimeve Njerezore", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh", "Administrim Territori" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Europian i Tiranës"**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Përfshirja e gjerë e stafit dhe e vetë studentëve në projekte dhe programe shkëmbimesh qëndron si një pikë e fortë në Departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut.
2. Organizimi i leksioneve të hapura dhe përfshirja e të ftuarve nga bota e bizneseve dhe më gjerë, të cilët ofrojnë ekperiencë të ndryshme të vlefshme për tregun e punës dhe për forcimin e edukimit sipërmarrës, janë një pikë tjetër e fortë e këtij programi studimi.
3. Pavarësisht lëvizjeve të stafit akademik, institucioni ka siguruar të ketë një staf të kualifikuar dhe të qëndrueshëm që kryesisht është në role drejtuese ose në kategorinë "profesor".

**Pika të dobta**


1. Aktualisht, praktika profesionale e këtij program studimi si një pjesë e rëndësishme e formimit të ciklit të dytë të studimeve, nuk realizohet pranë institucioneve dhe bizneseve që janë në lidhje të drejtpërdrejtë me programin e studimit.
2. Ambientet e reja të bibliotekës u vlerësuan të pamjaftueshme për të përfshirë të gjithë librat e fondit të bibliotekës. Studentët ose stafi akademik nuk kanë akses tek të gjitha librat ekzistente pranë këtij universiteti. Njëkohësisht u vu re mungesa e analizave statistikore në lidhje me përdorimin e bibliotekës online.
3. Fomulari i studentët i cili përdoret për vlerësimin e lektorëve është i përgjithshëm dhe nuk mundëson informacion në lidhje me përdorimin dhe përfshirjen e metodave inovative, tërheqëse, dhe të përshtatshme për lëndet përkatëse.
4. Megjithëse institucioni harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre programi i studimit nuk parashikon analiza dhe masa konkrete që duhet të ndërmerren në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.
5. Megjithëse politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të Sistemit të



Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente për personelin, këto informacione nuk janë të aksesueshme për studentët dhe të gjithë të interesuarit.

### **Rekomandime**

1. Praktika profesionale, si një pjesë e rëndësishme e formimit të ciklit të dytë të studimeve sugjerohet të kryhet pranë institucioneve dhe bizneseve që janë në lidhje të drejtpërdrejtë me programin e studimit. Marrëveshjet institucionale në kuadër të bashkëpunimit të mëtejshëm duhet të jenë sa më efektive dhe të aktivizohen dhe në këtë drejtim.
2. Rekomandohet të rriten kapacitetet dhe mundësitë e aksesimit të të gjithë librave ekzistentë në fondit të bibliotekës. Njëkohësisht rekomandohet kryerja e disa analizave statistikore në lidhje me përdorimin e bibliotekës online.
3. GVJ rekomandon rishikimin e fomularit që studentët vlerësojnë lektorët duke përfshirë dhe disa pika konkrete që nxjerrin në pah përdorimin dhe përfshirjen e metodave inovative, tërheqëse, dhe të përshtatshme për lëndet përkatëse.
4. Megjithëse institucioni harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, rekomandohet të kryhen analiza dhe masa konkrete që duhet të ndërmerren në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.
5. Megjithëse politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të Sistemit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente për personelin, këto informacione duhet të bëhen publike dhe për studentët dhe të gjithë të interesuarit.






**Conclusions of the evaluation of the second cycle study program, Professional Master in "Business Management", with profiles: "SME Management", "Human Resources Management", "Project Management and Evaluation", "Territory Administration" of European University of Tirana.**

**Strengths and Affirmations**

1. The extensive involvement of both, staff and students, in projects and exchange programs is identified as a strong point for the Department of Management and Marketing.
2. The organization of open lectures and the involvement of guests' lecturers from the business world and beyond, offering valuable experiences from the labor market and by strengthening entrepreneurial education, is another strong point of this study program.
3. Despite the movements of the academic staff, the institution has ensured to maintain a qualified and stable staff, mainly those involved in administrative duties or those entitled in the "professor" category.

**Weaknesses**

1. Currently, the professional practice of this study program, as an important part of the formation of the second cycle of studies, is not carried out at the institutions and businesses that are directly related to the study program.
2. The new library facilities were deemed insufficient to accommodate all the books in the library's holdings. Students or academic staff do not have access to all existing books of the institution. At the same time, there is a lack of statistical analysis regarding the use of the online library.
3. The students' form used to evaluate the respective lecturers is general and does not provide information about the usage and the introduction of innovative, attractive, and suitable methods for the relevant subjects.
4. Although the institution prepares periodic analytical reports on the profile and quality of incoming and outgoing students, as well as the degree of quality of their employment, the study program does not foresee concrete analyzes and measures that should be taken in order to improve these indicators.
5. Although the policy, strategy, organization and activities related to internal quality






assurance for the study program are transparent to the staff, this information is not accessible to the students and all other interested parties.

### **Recommendations**

1. Professional practice, as an important part of the formation of the second cycle of studies, is suggested to be carried out at institutions and businesses that are directly related to the study program. Institutional agreements within the framework of further cooperation should be as effective as possible and be activated in this direction as well.
2. It is recommended to increase the capacities and access possibilities of all existing books in the library fund. At the same time, it is recommended to carry out some statistical analysis regarding the use of the online library.
3. GVI recommends revising the form that students evaluate lecturers by including some concrete points that highlight the use and the introduction of innovative, attractive, and appropriate methods for the relevant subjects.
4. Although the institution prepares periodic analytical reports on the profile and quality of incoming and outgoing students, as well as the degree of quality of their employment, it is recommended to carry out concrete analyzes and measures that should be taken in order to improve these indicators.
5. Although the policy, strategy, organization and activities related to internal quality assurance for the study program are transparent to the staff, this information should be made public to students and all other interested parties.





**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				<b>X</b>
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				<b>X</b>
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				<b>X</b>
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				<b>X</b>
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				<b>X</b>
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

